


Pas heshtjes 25-vjeçare, më 2016 poeti Ilirian Zhupa u rikthye me vëllimin poetik "Të gjallë dhe të vdekur", vlerësuar në ishullin grek të Salaminës me çmimin "Aleksandri i Madh", si një nga zërat e veçantë të poezisë bashkëkohore. Në të njëjtën kohë boton edhe "Mos më pyet ku kam qenë", përmbledhje me poezi të shkruara 40 vjet më parë, duke ia sjellë lexuesit, të pandryshuar nga koha e botimeve të para...

ILIRIAN ZHUPA

**Krijuesi nuk është heroj.
Heronjtë në diktatura
vdesin. Unë vazhdoj
të jem gjallë...**



Portreti nga Ina Lajthia

OPINION

**KULTURA SI
JETË NDAJ
KULTURËS
PËR PËRDORJE**

nga Mimoza Ahmeti

(fq. 5)


**SHUMICA E NJERËZVE
KANË DASHURI
PËR SHKRIMTARIN,
POR KJO ËSHTË
E PABUJSHME**

nga Ismail Kadare



(fq. 6)

FILMI



**KINEMATOGRAFIA
NË KOSOVË
NË MES TË AMBICIEVE
DHE (PA)MUNDËSISË
FINANCIARE**

nga Gani Mehmetaj

(Fq. 12)

Xhejms Xhojs, forca gjeniale e përgjithësimit

nga Xhevair Lleshi

(Fq. 6)

**"Brigje të pikëlluara", historia e panjohur
e shqiptarëve në Turqinë e viteve 1912–1923**

nga Ryan Gingeras

(Fq. 10)



**SERVANTESI:
LOJA E BOTËS**

nga Harold Bloom

(Fq. 14)

Ribotohet nga Françeskanët

**"KANUNI I SKANDERBEGUT",
MBLEDHË E KODIFIKUE
PREJ IMZOT FRANO ILIA**

nga Imzot Angelo Massafra

(fq. 11)



**PËLLUMBAT
I VRASIN
NATËN**

VIRION GRAÇI

BIBLIOTEKË

**EPITAF
PËR VETEN**

NDOC GJETJA



Pas heshtjes 25-vjeçare, më 2016 poeti Ilirian Zhupa u rikthye me vëllimin poetik “Të gjallë dhe të vdekur”, vlerësuar në ishullin grek të Salaminës me çmimin “Aleksandri i Madh”, si një nga zërat e veçantë të poezisë bashkëkohore. Në të njëjtën kohë boton edhe “Mos më pyet ku kam qenë”, përmbledhje me poezi të shkruara 40 vjet më parë, duke ia sjellë lexuesit të pandryshuar nga koha e botimeve të para...

ILIRIAN ZHUPA

KRIJUESI NUK ËSHTË HEROI. HERONJTË NË DIKTATURA VDESIN. UNË VAZHDOJ TË JEM GJALLË...

Intervistoi: Violeta Murati

Së pari, z. Zhupa, ju urojmë shëndet të plotë, pasi morëm vesh që keni kaluar një periudhë të vështirë në këtë distancë gjeografike, por edhe njëfarë trysnie mbi shëndetin. Çfarë mendon njeriu? Secili ka përvoja, çfarë reflekton...

Edhe unë uroj mirësi e suksese për ju dhe ExLibris. E kam ndjekur në distancë gazetën tuaj dhe ju përgëzoj për këmbënguljen e dëshmuar për të mbushur sadopak këtë gollë komunikimi kulturor që e ndiejnë jo vetëm krijuesit, por edhe lexuesit. Duke ju falënderuar për interesimin për shëndetin, dua të pohoj se çdo sëmundje e rëndë e vë njeriun para provave të vështira. Është si të luash me detyrim ruletën ruse. Por me një ndryshim të vogël: në qoftë se naganti i ruletës ka mulli me 7 fole fishekësh, në këtë rast nuk është e mbushur me fishek një fole në shtatë, por gjashtë fole në shtatë... Shansi yt për të shpëtuar në çdo shkrepje është një në shtatë... Gjatë kësaj kohe më ka ardhur shpesh e më shpesh në mend filmi “Gjaktari i drerëve”, ku për së pari kam ndier realisht emocionet dhe ankthin e ruletës ruse.

Një vit nga publikimi i vëllimit poetik “Të gjallë dhe të vdekur”, botuar pas një heshtjeje 25-vjeçare, ju vlerësoheni në ishullin grek të Salaminës me çmimin “Aleksandri i Madh”, si një nga zërat më të veçantë të poezisë bashkëkohore. Pse u rikthyet te poezia dhe natyrshëm, pse heshtët aq gjatë?

I falënderoj përzemërsisht organizatorët dhe akorduesit e çmimit të artë “Aleksandri i Madh”. I çmësuar nga dritat e skenës dhe çmimet, në Salaminë shkova si dëshmitar i faktit se, kur krijimtaria jote mbërrin dhe lexohet diku, nuk ka nevojë për klan, fis, përkatësi interesash që të dallohesh, siç ndodh rëndom në vendin tonë. Më është bërë shpesh pyetja këto dy-tri vitet e fundit se pse u ktheva te poezia. Njëlloj si pyetja për fëmijën plëngprishës që pas një kohe bukur të gjatë kthehet në shtëpi, ose për kriminelin që kthehet në “vendin e krimit”. Në fakt, nuk jam kthyer! Kam qenë dhe do të jem te poezia sa të kem frymë. Është tjetër gjë publikimi, si intensitet i komunikimit me lexuesin. Thjesht, unë preferoj të publikoj e komunikoj rrallë.

Ka një fakt interesant mënyra se si e keni sjellë poezinë para lexuesve. Më 2016 ju vendosët të ribotoni librin e “realizmit socialist”, ku jeni shprehur se vjen totalisht i paprekur nga koha e botimit të parë, sikur është botuar më ’88... Pse ky vendim?

E kam shpjeguar edhe diku tjetër. Mbas leximit të ciklit “Ura” të librit “Të gjallë dhe të vdekur”, miku im Gëzim Basha më tha se do të ishte mirë që në cikël të përfshihej edhe poezia “Baladë për Vjosën dhe për vete” etj. E rilexova me atë sy librin e “realizmit socialist”, sikurse e quani ju. Gjeta veten time dhe bashkëkohësit e mi, sikurse i kam njohur dhe i kam dashur; gjeta veten në kapërcyell të moshës së rinisë; gjeta ëndrrat, pasionet, ngasjet, dhimbjet dhe vendosa të mos ua ndryshoj profilet, ngjyrat, frymëmarrjet, moshën... Dhe vendosa pa retush t’ia jap lexuesit të ri, për të riverifikuar veten...

A keni pasur ngasje për ta ndrequr, riparë...?

Po. Mendimi i parë ishte që ta ribotoja duke i bërë një redaktim dhe përafrim me variantin në dorëshkrim. Por me një praktikë të tillë më dukej sikur do të fyeja gjithë ata lexues që e kishin shijuar dhe e kishin bërë të vetën poezinë time në formën që ajo është botuar. Më tej, nëse do t’i ndryshoja e redaktoja poezitë, do të më dukej vetja si ata që falsifikojnë datëlindjen në certifikatën e lindjes, ose profesionin me dëftesën e pjekurisë dhe diplomën. Kjo ishte arsyeja e parë.

Arsyeja e dytë ishte që këtë fëmijë shpirtllirik që jetoj dhe krijoi në kohë të vështira, t’ia përcjell lexuesit të ri, energjik e naiv, ashtu siç ka qenë.

Pastaj, një arsye tjetër shumë e rëndësishme ishte edhe neveria që kam ndier në këta 30 vjet ndaj një pjese të madhe bashkëkombësish të cilët kapërcejnë të gjitha ylberet, bëjnë të gjitha lakoret e ndërhyrjet mbi trupin dhe shpirtin e vet, për t’u dukur ndryshe, bashkëkohorë, largpamës, të pacen e heronj... pra, ndaj racës së të përshtatshmëve që shtohet e shumohet ndër viset tona.

Ju keni një mendim se, ndryshe nga proza e cila botohet e ribotohet, librat me poezi botimin e tyre të parë e kanë përgjithësisht edhe të fundit. Pse kjo bindje, ku është konteksti?

Kur flas për prozën, kam parasysh novelën dhe romanin që i mbijeton kohës dhe ka mundësinë të ripublikohet si libër më vete. Jo për çdolloj proze. Kjo gjë ndodh edhe me tregimin, siç ndodh edhe me poezinë, por jo me të gjitha tregimet dhe poezitë e përfshira në një libër. Kësisoj, nga një libër me tregime apo me poezi mund të ripublikohen vetëm ato që mbeten, ato që kanë magjinë e rileximit. Të tjerat që kanë dhënë shpirt që në leximin e parë, është mirë të mos u zënë frymën krijimeve të njëmendta. Për këtë arsye është e vështirë të ribotohet një libër poezie apo tregimi në mënyrë integrale.

Thoni se keni bërë disa lëshime kur botuat më 1988 këtë libër. Duam të dimë të ç’natyre ishin, ideologjike...? Çfarë shkaktonte, në rastin tuaj, kjo ndërhyrje – sot p.sh., nuk perceptohet dot sa e kishit koshiencën...?

Në të gjitha kohët, në të gjitha vendet dhe në të gjitha sistemet, me vetëdije apo jo, njerëzit në përgjithësi, por edhe njerëzit e artit në veçanti, bëjnë lëshimet dhe kompromiset e veta. Kjo është ajo që shpesh me një gjuhë të rumbullakosur ne e quajmë vulën e kohës, vulën e shoqërisë ku jetojmë etj. Epitetet që përdorim për të përcaktuar ngjyresat e një vepre letrare në këtë aspekt, sot e gjithë ditën, më shumë sesa cilësi, për fat të keq, përfaqësojnë ambalazhe prirjesh, zhvillimesh, modash... Por le të kthehemi në mënyrë konkrete te pyetja juaj. Lëshimet e bëra në librin “Mos më pyet ku kam qenë” janë edhe ideologjike, edhe tematike, edhe leksikologjike dhe për pasojë, edhe lëshime artistike... Pavarësisht nga këto që thashë më sipër, libri është një përmbledhje poetike që në shumicën e poezive të tij është lexuar me ëndje dje, lexohet me kënaqësi sot dhe besoj do të lexohet po ashtu nesër... Për shkak të lëndës dhe trajtimit artistik të tij. E kam thënë që krijuesi nuk është heroi. Heronjtë në diktatura vdesin. Unë vazhdoj të jem gjallë...

Në fakt, ju i përkisni të ashtuquajturit “brezi i viteve ’80”, keni kaluar 33 vjet krijimtari. Si thoni, “sa është koha e kryqëzimit të Krishtit”, më lehtë për ta shprehur tani, në liri, por pyetja që ngre është se sa jeni përpjekur të mbroheni nga “morsa e metodës socrealiste”? Përmendni diku se i keni bërë një “gjq të gjatë në heshtje shoqërisë letrare dhe vetes”. Ka një zbulim të këtij mendimi, pra, të na e thoni me zë të lartë?

Vërtet kemi qenë një brez në moshë dhe në art që erdhëm dhe krijuam profilet tona të qarta në vitet ’80. Dhe, pak a shumë, në vitet e ndryshimeve të sistemit të gjithë ishim rreth moshës së kryqëzimit të Krishtit. Në moshën e kryqëzimit, por të pakryqëzuar ende. Pavarësisht se një pjese prej nesh i ishte vënë mbi shpinë kryqi i kryqëzimit dhe ishim goditur me gurë dhe kamxhik ndërsa përpiqeshim të vazhdonim rrugën... Afrimi drejt dritës ka qenë gradual. Duke u rritur filluam të ndiejmë ngushtësinë e gjërave në trup dhe në mendje. Kjo duket qartë për të gjithë ata që ndjekin rrugën e krijimtarisë. Ndërsa dua të bëj një pohim para gjithë atyre që nuk e kanë njohur atë sistem: 99.99 për qind e njerëzve votonin pro në

ILIRIAN ZHUPA

Të gjallë
dhe
të vdekur

poezi



BOTIMET TOENA



farsat elektorale. Dhe këtu përfshiheshin komunistët, besnikët, klakerët, të pakënaqurit, të shpronësuarit, të deklasuarit, ish-të burgosurit etj. *Regjimi dhe njerëzit, sa më shumë e njihnin njëri-tjetrin, aq më shumë luanin bllofin me njëri-tjetrin. Për të ruajtur atë minimum që ishte jeta e tyre dhe e fëmijëve.*

Ndaj, për këtë arsye, brezat e lindur dhe të rritur në diktaturë, veçanërisht njerëzit e penës dhe të mendjes, të gjithë pa përjashtim, kanë nevojë të bëjnë në mos gjyqin, katarsisin e tyre...

Poezia juaj, dëshmi a rrëfim, kur një poet e ndien kohën e tij?

Poezitë e mia, vargjet e mia, fjalët e mia të thëna publikisht, janë pasqyra e prizma ku pasqyrohem unë, me gjithçka që jam, kam, më mungon, besoj, vë në dyshim, dua, urrej, kam frikë, bëj luftë, gjej paqe... Në të gjitha nisjet vetjake që përmenda, është koha ime reale. Më tej fillon koha ime poetike, e cila është dje dhe pardje, sot dhe tani, nesër dhe pasnesër. Koha që në një mënyrë më të përgjithshme mund të përkufizohet si Koha e Njeriut, nga fillimet e gjer në fundin e saj. Duke "situr" veten, kam mbajtur nga ajo atë lëndë poetike e

cila nuk është vetëm e ditës, motit, shekullit tim, por e gjithëkohshme. Uroj t'ia kem arritur.

Ç'gjurmë lë koha te një poet? Fjala është për ato që keni krijuar ose, më mirë, diktoheshin nga trysnia e viteve '80?

Vjetrimi është pjesë e procesit të jetës. Vjetrohen njerëzit, vjetrohen sendet, vjetrohen fushat e malet, qiejt e detet, drita dhe errësira. Vjetrohet Toka, kozmosi... Koha lë shenjat e veta në gjithçka. Në një pjesë të krijimtarisë sime të hershme dallohen qartë shenjat dhe vratat e kohës. Më shumë në librin e parë "Diell mbi kasketë". Më pak te libri "Poezi" e te botimet e tjera më parë. Me afrimin e kohës, autori përpiket të gjejë alkiminë e mosvjetrimit.

Si duket fëmijë kemi qenë pa e ditur/ Mister kemi bërë një gjë kaq të thjeshtë/ Ke ardhur – kam beshtur, ke ikur – kam thirrur/ Dimër për dimër e vjeshtë për vjeshtë – ka një lloj racionaliteti për t'u shprehur, për të thënë mundimin. Pse një poezi kaq e ndrojtur, siç më duket? Është kjo natyrë juaja?

Dashuria gjithmonë është delikate, e druajtur. Uria, etja janë tjetër gjë: bërtitëse, agresive... Në dashuri

njeriu paston pasqyrat që i vishen me avuj, rregullon këndshikimet e tyre, me qëllim që tjetra të duket më e bukur, më e fisme. Kësisoj, ajo bëhet njëherësh më e paarritshme, më e lakmueshme dhe më e mistershme.

Nuk besoj se ka dashuri pa ndrojtje dhe mister. As ngasje kalimtare...

Shumë e lehtë të bësh poezi për atdheun, punëtorin, minatorin, babanë, nënën, por, siç duket, aspak e lehtë për të dhënë emocione intime. Pse?

Pikërisht për të bërë poezi për atdheun, punëtorin, babanë, nënën etj., është shumë e vështirë. Ka vargëzime pa fund për ta, por poezi të vërteta janë pak. Kjo për arsyen se kur shkruan për ta, duhet të kesh një ngasje dhe një materie poetike të dorës së parë.

Cikli mësimi matematike, në fakt, përmban disa mësim për fëmijë, për vajza, për djem, për gra, për burra... dhe në fund, ç'mësimi i mësimëve. Më duken të gjitha një dialektikë moralizuese. Pse ky ngacmim? Ka diçka brenda jush që nuk gjen shoqërinë ideale në tërësi?

Ky është një cikël poetik stigmatizues i librit "Mos më pyet ku kam qenë". Nuk është moralizim dialektik, pasi në mënyrë dialektike qasja hipokrite ndaj jetës dhe shoqërisë do të ishte minimizuar. Por, në fakt, ka ndodhur e kundërta. Qasjet hipokrite janë shtuar e shumëzuar dhe për fat të keq, unë nuk prita gjer më tash që t'i paraqisja më të plota artistikisht. Shoqëria ideale ose shoqëria e mirë ekzistojnë vetëm në ëndrra.

Si vdesin idetë e lira?

Idetë e lira vdesin përditë si njerëzit, gjallesat dhe bimët. Vetëm se ato vdesin me heqë më të rëndë se ata. Kur vdesin njerëzit, në çdo tokë të bien, nuk rilindin më. Kur vdesin bimët, nëse farat e tyre bien në tokë të shëndetshme, ato rimbijnë... Kur vdesin idetë e lira, mund të kalojnë shumë breza gjer në mugullimin e tyre sërish.

Çfarë ndodh me ndjenjat e një poeti kur i shtrëngohet liria, shqisa e krijimit?

Ajo që ndodh me njeriun kur i rrallohet ajri, p.sh., kur rrezikohet të mbytet. Së pari, ekonomizon oksigjenin që ka brenda mushkërive; së dyti, përpiket t'u shmanget shtjellave thithëse; së treti, synon të gjejë objekte rrethanore që mund ta ndihmojnë të ngjitet drejt sipërfaqes dhe më tej, synon të notojë me të gjitha fuqitë drejt dritës...

Çfarë ka qenë jashtë realitetit në poezitë e tua të krijuara para '90-ës?

Të gjitha kanë qenë brenda, edhe kur ia kanë pasur me hile realitetit.

Si i shikonit atëherë lidhjet me gazetën letrare "Drita"? Çfarë ishte kjo media për ju? Shoh që aktualisht ka shumë nostalgji, të shumtëve iu mungon. Pse?

E vështirë ta qartësoj për ju! Ishte e vetmja gazetë letrare, si të thuash, e vetmja "plasë" nga mund të shihje qiejt e krijimtarisë. Ishte shkallarja që nëse ngjiteshe, kishe shpresë që krijimtaria jote artistike të dilte në dritë...

Kur u janë botuar poezitë e para, kam një informacion se Anastas Kondo ka bërë një shkrim për ju me titullin "Një dhëndër i ri i poezisë sonë". Si e kujtoni?

Poezitë e para janë botuar herët. Në vitin 1985 Anastas Kondo botoi një shkrim dy faqe te gazeta "Drita", për librin tim të dytë me titullin "Poezi". Gjithsesi, kur e kujtoj, vetja më duket se kam qenë një dhëndër i ri i poezisë shqipe.

M'u hapën shumë porta nga ai shkrim dashamirës dhe i jam mirënjohës autorit në jetë të jetëve...



Kalojmë te libri tjetër, “Të gjallë e të vdekur”, ku thoni se ka ndenjur në sepete duke bërë provën e rezistencën përballë rrjedhës së kohës. Çfarë duhet të nënkuptojmë me këtë?

Për herë të parë libri “Të gjallë dhe të vdekur” ka qenë “i bërë” në vitin 1992. Mosbotimi i tij në atë kohë solli që ky libër të bëhet dhe të zhbëhet njëzet e ca herë, aq sa vite kaluan gjer në botimin e tij. Nga “lënda” e parë në këtë libër janë vetëm çereku i vargjeve të variantit të parë. Pjesa tjetër ka ndryshuar nga një në njëqind për qind. Po të rrinte dhe më shumë “në sepete”, me siguri do të ishte edhe më i mirë.

Pse i jepni kaq shumë rëndësi “vdekjes” në këtë vëllim, edhe kur bëni “apel për të gjallët”? Si perceptohet kjo nga një poet?

Çdo formë e lindjes së jetës në këtë botë sjell me vete edhe lindjen e vdekjes së saj. Përjashto rastet aksidentale, vdekja është e fiksuar në çdo qelizë të rritjes sonë. Tërë jetën, qenia njerëzore e bën të paqenë këtë pjesë shoqëruese. Prej egocentrizmit, ekzistencializmit, frikës, lakmisë? Nuk di ta them! Si struci që fut kokën në rrëzë dhe thotë: “Dashtë Zoti qoftë ëndërr!”

I admiroj ata popuj që e pranojnë vdekjen si pjesë të së tërës. Nëse jeta është fara, vdekja është humusi i shëndetshëm i rritjes së saj.

Në këtë vëllim flisni për Njeriun. Keni ikur nga lirizmi i parë, fryma e parë, pse?

Njeriu ndoshta përfundimisht e ka humbur fëmijërinë e vet. Bashkë me lirizmin, ndjeshmërinë, solidaritetin real. Në mos e ka humbur, nuk “e konsumon” më këtë produkt. Sidoqoftë, unë sërish ia shtroj produktin në tavolinë, por me porcione më të vogla dhe më të konsumueshme.

Janë vargje tronditëse që e kanë një shkak te poezia “Ikja e dherave”, ku shkëpus vargjet e fundit: *Ikja e dherave është ikja e gjakut dhe shpirtit tonë/ të brishtë. Prej skeleteve...* Çfarë të tremb nga kjo, sa metaforë aq edhe një gjendje reale?

Tashmë unë po jetoj jetën e dytë të Krishtit. Gjatë jetës së parë provova gjithë mungesat, gjatë jetës së dytë po provoj ikjet. Në formë fizike dhe në formë morale. Ka ikur pjesa më e butë dhe më produktive e njerëzve tanë. Pra, a po varfërohemi si “tokë” në aspektin fizik. Aspekti moral është edhe më i dhembshëm: kanë ikur idealet – janë shtuar demagogjitë; kanë ikur atdhetarët – janë shtuar tregtarët e flamujve; kanë ikur të ndershmit – janë shtuar hajnat; ka ikur shpresa – është shtuar pasiguria...

Asnjë metaforë nuk e rrok dot këtë gjëmë.

Mos gabo, me “Pema e ëndrrës”, botuar në Prishtinë, jeni nderuar me çmimin “Libri më i mirë i vitit”, të cilin e konsideroni një urë mes lexuesve tuaj historikë dhe lexuesve të rinj. Ka një përkatësi kjo periudhë?

Është periudha e ëndrrave të mëdha dhe shpresave të mëdha. Pavarësisht mureve ndarëse, poetët dhe shkrimtarët ketej dhe matanë kufirit ishin në stinën kur shumonin mundësitë e komunikimit të ndërsjellë. Distanca dhe keqkuptimet, në këtë aspekt, ishin më të vogla se sot, pavarësisht murit në mes.

Momenti tjetër i krijimtarisë pas 1991-2015, një tablo ekzistenciale që thoni se është fillimi dhe fundi. Çfarë ju ka mbetur pa zbuluar? Si një poet e ndien ndarjen... apo nuk ka diçka të tillë?

Gjëja e madhe fle dhe zgjohet me mua, por nuk është zbuluar e thënë ende. Më pret në tavolinën e shkrimit, në kanapën e çlodhjes, në relaksin dhe ankthin, në gëzimin dhe sëmundjen...

Si qenie njerëzore dhe krijuese, përpiqem të shtoj harqet e urës mbi boshllëkun që është zotërues.

E pafajshme jam – një kompozim emblemë i Adi Hilës, kënduar mjeshtërisht nga Aurela Gaçe – ka një dramë të fortë kjo këngë, ashtu si gjithë përmbledhja e “Të gjallë e të vdekur”, shoqëruar nga një perceptim personal se keni “marrë hak” për gjithë trysninë mbi ndjeshmërinë tuaj, mes kohëve, para dhe pas ’90-ës. A është kjo e saktë?

Pak a shumë kështu... Një këngë e tre të pafajshmëve që tentojnë qiejt, duke qenë të lidhur me zinxhirë në tokë...

Dua t’ju kujtoj edhe një tjetër këngë, “E kemi fatin shpresë e marrëzi”, sërish me Aurelën, por këtë herë me kompozimin e mjeshtrit Ferdinand Deda. Tekst tronditës, pa dyshim një nga kompozimet më të arrira të këngës së lehtë qysh pas rënies së diktaturës. Çfarë na kujtoni nga ky bashkëpunim? Ç’fuqi merr një tekst prej muzikës?

Të madhin Ferdinand Deda e takova disa muaj pasi ishte kënduar kënga. “Kumbari” për bashkëpunimin u bë Aurela Gaçe. Teksti, muzika dhe interpretimi janë “tri këmbët e perustisë” në këtë rast. Të tria të përsosura, për të jetuar gjatë.

Ka një përgjigje poezia për të gjitha ashpërsimet e jetës, kujtoj poezinë “Kalimtar i rastësishëm”, në formë e përmbajtje kryen një akt: *...Ai i do të gjitha për vete, për të dashurën, fëmijët, gruan, fisin dhe ortakët e tij...* duke “degraduar”, hequr deri në vargje therëse: *Ai i do të gjitha, Ai i do, Ai...* Cili është ky “Ai” – ku, interesante, shënوني për këtë poezi datimin 2005-2015, pra 10 vjet distancë?

Kjo poezi nuk është shkruar për të deklaruar listën e atyre që janë shfaqur të tillë në jetën time. Përmes saj, ata e kanë marrë mesazhin dhe unë kam paguar e vazhdoj ta paguaj haraçin. Kjo poezi është botuar si një guidë për ju, që të identifikoni të ngjashmit që ju rrethojnë dhe ju grabisin truallin, mundësitë, ëndrrat, sendet, liritë.

Fatkeqësisht, jetën, prosperitetin dhe realizimin tonë shpesh na e përcaktojnë “Të rastësishmit...”.

Kombi im të kam komb në fyt/ as të vjell dot/ as të gëlltit... – rebelim? Çfarë është?

Është dhimbje në shpirt, në trup, në mendje... Është pjesa ime jetësore dhe plaga ime që nuk do të mbyllet kurrë.

Poezitë kanë masë lirizmi, me atmosferë melan-kolie që sot nuk është tendencë, kam përshtypjen është e fillimit të ’90-ës, kur nisën shpresat... Sa vetëdije poetike keni pasur në këtë periudhë?

Edhe në poezi jetojmë në një kohë erozioni. Pjesa e butë, e ndjeshme, melankolike, pra njerëzore, shihet si e tepërt. Mendoj që është një modë që do të kalojë. Siç ka kaluar edhe më parë...

Poezia, me ndjeshmërinë, magjinë e imazheve dhe filozofinë e saj, është “zemereku” i qenies njerëzore. Pavarësisht nga robotizimi aktual i botës.

Një pyetje sa klasike, aq edhe klishe, që ka munduar jo pak shkrimtarë kur pyeten: përse shkruani?

Sepse marr frymë...

Fati i njeriut të vogël që emocionalisht është lidhur me tokën e vet – këtë kanë vërejtur në lirikën tuaj sociale, ku zënë vend edhe krijimet autobiografike. Ç’është ky raport i të krijuarit me të kaluarën, apo përfshirja e tij në shqetësimet e ditës?

Në fakt, bota humane është bota e “njeriut të vogël”. Pema është e lidhur me tokën për shkak të rrënjëve, njeriu – për shkak të ADN-së. ADN-ja është edhe autobiografi, edhe e kaluar, por edhe e ardhme. E shprehur më thjesht, njeriu është si lëngjet, që marrin shijen dhe erën e fuçisë ku maturohen.

Raporti me vetminë?

Për mua vetmia është një liri krijuese absolute. E domosdoshme, por e paarrtshme...

Cilët kanë ndikuar në qenien tuaj si poet, por edhe në poezi? Çfarë keni admiruar?

Janë jashtëzakonisht shumë, por meqë duhet... Babai, Natyra, Walt Whitman dhe...

Mendoni se e keni lexuesin tuaj?

Nuk e di! Në këta dyzet vjet krijimtari ai vetëm është rritur. Shpresoj që do të rritet edhe më shumë në të ardhmen, kur unë të mos jem...

SHUMICA E NJERËZVE KANË DASHURI PËR SHKRIMTARIN, POR KJO ËSHTË E PABUJSHME

nga Ismail Kadare

Ti e di mirë se kudo në botë çdo shkrimtar a artist i shquar krijon vetvetiu kundërshtarë. Me arsye, pa arsye, me kinse arsye. Në qoftë se kjo është një e vërtetë botërore, gjithëeuropiane, mendo se ç'trajta groteske merr në Ballkan, e sidomos në vendin tonë të dashur.

Të marrin inat njerëzit për gjëra që s'të vete mendja: për kapelën që ke vënë, ose nuk e ke vënë, për ecjen, për të fejuarën, për kanapenë, për romanin, për një Zot e di çfarë. Më kujtohet se ty të merrnin inat pse rrije i pikëlluar në kafene. Madje, më ke thënë se ta kanë përmendur edhe në hetuesi.

Këto gjëra unë i di prej kohësh dhe nuk më shqetësojnë. Nuk më shqetësojnë, sepse di gjë tjetër: që shumica dërrmuese e njerëzve kanë dashuri për shkrimtarin. Por kjo shumicë, ndryshe nga zhgani tjetër, është e pabujshme. Madje, kjo dashuri e shumicës shkakton nervozizëm te disa. Të tillët fillojnë të mos të duan pikërisht se të duan të tjerët.

Meqenëse e zbuluam se jemi në një ngecje e zvarritje kafkiane, më lejo të të tregoj një ngjarje që lidhet me dashurinë për letërsinë.

Më 1995, në Luksemburg u themelua Akademia e Poezisë. Ceremonia ishte luksoze. Kishte shkrimtarë e poetë të njohur nga gjithë bota. Unë mbajta fjalën e hapjes.

“

Të marrin inat njerëzit për gjëra që s'të vete mendja: për kapelën që ke vënë, ose nuk e ke vënë, për ecjen, për të fejuarën, për kanapenë, për romanin, për një Zot e di çfarë...

Ditën e tretë në mbrëmje, pak përpara darkës së lamtumirës, më thanë se te hyrja e hotelit më kërkonin. Ishin një grup shqiptarësh, rreth 30 veta, të gjithë mërgues në viset përreth. Shumica kosovarë. Kishin marrë vesh në TV praninë time dhe deshën thjesht të më takonin. Ndonëse ishin të ndrojtur e fjalëpakë, qëndruam rreth një orë bashkë. Pastaj u thashë se duhej të shkoja në darkën e mbylljes. U ngritëm të gjithë dhe më kërkuan leje të më shoqëronin gjer te ndërtesa ku bëhej darka. Kaluam kështu mospërmas parkut. Kur iu afruam sallës, pas qelqeve të së cilës rrezëllinin dritat, ngadalësuam hapat. Kështu, unë përpara, ata pas, iu afruam hyrjes. Aty u thashë natën e mirë dhe ngjita shkallët. Kur ktheva kryet pashë se rrinin ende aty, si një mur i heshtur, në këmbë, me sytë nga qelqet e



sallës. Ndërkaq, shumë të ftuar ishin bërë kureshtarë për ta dhe ishin afruar te qelqet për të marrë vesh se ç'ndodhte. Organizatorët e darkës gjithashtu. U thashë se ishin shqiptarë refugjatë, shumica nga Kosova, ndaj dukeshin aq të zymtë.

Po mbërrinin të ftuarit e fundit, pritej Dukësia e madhe që do të kryesonte darkën. Te qelqet ndërkaq ishin shtuar poetët që vështronin përjashta grumbullin e shqiptarëve. Ishin krejt të mahnitur nga ajo pamje epike, nga ai seriozitet, nga ajo përzitje madhështore. E kishin ëndërruar, siç më thanë pas pak, një lidhje të tillë me lexonjësit e tyre. Një marrëdhënie të tillë, që ngjante e rrezikshme dhe funebre, ngaqë poezia përzihej me lirinë ose, më saktë, me mungesën e saj.

Kështu, për njëfarë kohe të dyja palët vështruan

njëra-tjetrën, të ndarë nga qelqet e mëdha. Kur i pashë të largoheshin, ashtu si një mur i errët, i huaj për këtë botë, moskuptues, antik, mendova se ky ishte muri i popullit tim, që një ditë mund të më zinte nën vete e unë kësaj as do të mundja e as do të doja t'i shmangesha.

Ta tregova këtë që të më kuptosh se përse unë nuk u jap rëndësi më shumë seç duhet xhuxhëve dhe spiunëve. Janë këto qoka (referenca) të mëdha që na kanë mbajtur gjallë. Ndryshe prej xhuxhëve mund të çmendeshim. Ose të bëheshim edhe ne xhuxhër, si ata.

Është kjo arsyeja që unë kam falur shumë gjëra. Ti më njeh, unë s'jam natyrë e butë. Veç kësaj, vij nga një qytet që ka qenë shquar për meritë e gjata. E megjithatë, është falja ajo që më ka kthjelluar shpirtin.

XHEJMS XHOJS FORCA GJENIALE E PËRGJITHËSIMIT

nga Xhevair Lleshi

Xhejms Xhojsi është quajtur monument i kulturës botërore, që themeloi bashkë me Marsel Prustin drejtimin letrar të quajtur *Lumi i ndërgjegjes* dhe arriti të krijojë vepra madhore që, për fat të mirë, kanë ardhur në shqip, *Uliksi*, *Dublinasit* etj.

“Rrjedhë e vetvetishme ndijmësh, mbresash dhe kujtimesh”, – e quan Xhojsi thelbin e kësaj rryme letrare që thithi shpejt vëmendjen në krejt botën letrare të shek. XX, duke qenë se kishin shfrytëzuar me mjeshtëri arritjet në fushën e psikanalizës dhe të intuitivizmit, teori këto që kanë folur për mundësi të pakufishme për të depërtuar në brendësi të shpirtit, për mundësi njohjeje deri në skutat më të errëta të tij dhe për të ravijëzuar proceset psikologjike që i ndodhin njeriut.

Xhejms Xhojsi (James Joyce) ka prejardhje irlandeze. Ka lindur në Dublin në vitin 1882, ku mori arsimin fillor e të mesëm. Ishte koha e luftës së irlandezëve për pavarësi nga Anglia dhe periudha e Rilindjes Kombëtare Irlandeze, ku konfliktet sociale dhe politike gërshetoheshin me konfliktet fetare: protestantët luftonin kundër katolikëve. Xhejms Xhojsi u regjistrua në një kolegji jezuit që e mbaroi me rezultate të mira dhe u regjistrua në Universitetin e Dublinit në Fakultetin e Filozofisë. Në mbarim të tij u mundësua detyra e pastorit, por që nuk u pranua prej Xhojsit, duke iu përkushtuar përfundimisht artit.

Ç’ndodhte me Xhejms Xhojsin? Asgjë e çuditshme dhe as e rënë prej qiellit: ai nuk u përfshi në luftën politike, nuk hyri në asnjë rrymë fetare, ndiqte me interesim të madh gjithë ç’ndodhte në Irlandën e tij, kontribuoi në dobi të çështjes kombëtare, debutoi në

teatër që luante rol të madh në vetëdijen kombëtare irlandeze, nxiste synimin e bashkatdhetarëve për çlirim kombëtar, e interesonte shumë krijimtaria e Ibsenit; çmonte lart poezinë e Pol Verlenit, shkroi artikullin *Drama dhe jeta* (1900), u gjend para prirjes së letrarëve irlandezë për burimet e kulturës irlandeze, e interesonte studimi i folklorit dhe i gjuhës së vjetër irlandeze... Qysh në këtë fillim ekstravagant dhe të thellë, premtues dhe elegant, mund të thuhet se po fillonte epoka e madhe e tij, e një letërsie krejt ndryshe... Shí në këtë kohë Xhojsi shtroi nevojën e madhe të përhapjes në vend të kulturës europiane...

Ç’rrugë ndoqi Xhejms Xhojsi? Në vitin 1902 shkoi në Paris, jetoj aty një vit, ku gjeti me dinjitet mundësinë e njohjes së thellë të burimeve të kulturës europiane. Dhe u kthye në Dublin duke përjetuar keqësimin e gjendjes shëndetësore të së ëmës, që vdiq në vitin 1903. Pas një viti Xhojsi u martua me Nora Barnaklin dhe të dy bashkë u larguan nga Dublini duke jetuar jashtë në Trieste, Zyrih e në Paris, ndërkohë që herë pas here kthehej në atdhe. Në fillim të Luftës së Dytë Botërore Xhojsi vendosi që të kthehej përfundimisht në Dublin, por nuk ndodhi, pasi vdiq në Zyrih në vitin 1941...

Irlanda u bë qendra e “lëvizjes tektonike” në krijimtarinë e Xhojsit. Romani *Portreti i piktorit në rini* (1916) dhe kryevepra *Uliksi* (1922), vëllimi me poezi *Muzikë dhomë* (1907), tregimet *Dublinasit* (1914), *Një peni copa* (1939), *Përshpirtja e Fineganit* (1939), drama *Mërgimtarët* (1918), dhanë përfytyrimin e tij për Irlandën, duke i kumtuar botës modelin më të mirë të saj. Xhojsi e provoi penën në të gjitha gjinitë dhe llojet

letrare, por romani voluminoz u bë tehu i thikës ku ai eci artistikisht, mbështetur në parimin ideoartistik të *Lumit të ndërgjegjes*, në të cilin i dha përparësi thellimit në analizat psikologjike të botës së njeriut, duke u mbështetur sidomos në proceset e pavetëdijshme. Ka përkthyer në anglisht dramën e Hauptmanit, kurse Oskar Uajllidin e ka interesuar si shprehës i pikëpamjeve të tij estetike. Është autor i shumë artikujve për letërsinë...

Pse romani *Uliksi* e bëri të famshëm e të pavdekshëm Xhojsin?

Për origjinalitetin e dukshëm e të patjetërsueshëm, për befasinë kuptimore të brendisë, për trajtimin si enciklopedi të modernizmit, për nocionet dhe dukuritë e diskutueshme artistike, se gjërat dhe temat që mezi pranohen janë kurdoherë interesante, se fryma e tij e lartë artistike kurdoherë shkakton debat, se...

Pse Xhejms Xhojsi mbahet si krijuesi më në zë i miteve të shek. XX? (Pas tij erdhën e u afirmuan me krijimtarinë e tyre moderniste shkrimtarë të tjerë të shquar – Kamyja dhe Kafka.)

Konceptimi mitologjik i ngjarjeve dhe i personazheve, Përgjithësimi i përmasave të mëdha të dukurive jetësore, Krijimi i përfaqësuesit universal bashkëkohës, Abstragimi i skajshëm i dukurive, Dukja “e vështirë” e të kuptuarit të asaj që shkruhet që (me ta kuptuar) të lë të mahnitur, Forca gjeniale e përgjithësimit, Abstragimet bëhen deri në praninë e absurdit, Miti i rikrijuar artistikisht buron nga jeta e gjallë, Eksperimentimi i luhatjeve të vetëdijes njerëzore, Rrëfimi i vëmendshëm e me forcë vepruese, Shtysat e nënvetëdijes në situata të caktuara, Shtysat e nënvetëdijes tregohen përcaktuese të sjelljeve dhe të veprimeve të personazheve, Rrëfim artistik i lartësuar, Art novator, Sjellje personazhesh që jo rrallë është befasuese, Zhbirime të thella të botës psikologjike, Përparësi riprodhimi artistik i kujtimeve – ëndrrave – pasojave – përjetimeve, Fantazi krijuese me liri të pabindur e të plotë, Skena të jetës dublinase artistikisht të larta përplot mbresa të fuqishme, Skalitje karakteresh në mosrespektim të artit realist, Dialektikë e zbehtë e kushtëzimit objektiv të karaktereve prej mjedisit dhe individualitetit...

Sepse... është vepër që të befason me forcën e artit të madh...

Po ç’është Xhojsi?


Mjeshtër i dhënies së formave të ekzistencës së qenieve njerëzore të skalitura prej tij, Mjeshtër i evidentimit të ligjësisë të ekzistencës së qenies, Artist i shpërfaqjes së pasioneve dhe të instinkteve, Kolos i dhënies së befasive funksionale, Shkrimtar i veçantë në mishërimin artistik herë-herë të munguar të arritjeve në personazhe të individualizuara (që kanë fytyrën e tyre të papërsëritshme), I papërsëritshmi që nuk e ka për osh individualizimin artistik të personazheve e të mjedisëve, Mjeshtër për të dhënë një paraqitje të përgjithësuar e të abstraguar të personazheve e të mjedisëve, I habitshëm se si ndërton narracionin që rrjedh e rrjedh pa mbarim, I paarritshmi artist kaq i madh që tregohet indiferent dhe nuk bën asgjë për ta kanalizuar apo duke mos e përzier në narracion këtë individualizim, Mjeshtër që i lë ngjarjet të ndjekin logjikën e tyre të vetvetishme...

Po estetika e Xhojsit? E hallakatur? Interesante? Brenda *Lumit të ndërgjegjes*? Shfaqje e papritur e Zotit? Çaste kulmore të qartësisë së njeriut? Çaste tendosjeje të madhe? Gjendje përjetimesh tronditëse? Anashkalim i gjendjeve të rëndomta? Nënkuptime domethënëse? Thjesht konstatime? Mbresa të tjetërsuara?...

Si qëndroi kaq gjatë Xhojsi duke krijuar një model artistik të botës apo një rikrijim artistik të jetës universale? Po, kjo është e qartë: *ai iu drejtua mënyrës mitologjike të rrëfimit*, për realizimin artistik të idesë. Pse, mos është e rastësishme që romani të titullohet *Uliksi*? Tërheq si magnet emri i heroit mitologjik Odisea, por ai i Xhojsit është Uliks, bashkëkohës. Përfytyroni pak: një ditë nga jeta e personazheve kryesore: Leopold Blum (nëpunës në redaksinë e një gazete të Dublinit) ka fatin e Uliksit, Merioni (Moli) në fatin e Penelopës dhe Stiven Dedali (një shkrimtar që e nxjerr bukën e gojës duke punuar mësues historie në një shkollë të Dublinit) në mitin e Telemakut, janë konceptuar në përmasa vigane, që përgjithësojnë njerëzimin, kurse Dublini përgjithësohet si qendër e botës. Data e zgjedhur është 16 korrik 1904, pa përshkrime të ngjarjeve, në rrjedhë të lirë të shtjellimit të subjektit në 18 episodeve të rikrijua përplot monologë të brendshëm, zhbirime të holla të psikikës dhe të nënvetëdijes, roman me 2500 fjalë që mbyllet me një *Po*. Dhe ndihet qartë muzikaliteti i gjuhës së përdorur...

Përshpirtja e Fineganit është romani i fundit i Xhojsit.

Xhejms Xhojsi është shkrimtari që përmbysi përfytyrimin tradicional për strukturën e romanit, shkrimtar i formave të reja dhe i mishërimit artistik tjetërsor të jetës. Mbretëron *Uliksi*...



KULTURA SI JETË NDAJ KULTURËS PËR PËRDORJE

nga Mimoza Ahmeti

Një nga diskutimet që tërheq vëmendjen individuale sot, është lloji i njeriut brenda kulturave. Por edhe mënyra e përdorimit të kulturave brenda njeriut diskutohet. Të dyja këto përcaktojnë jetën e kulturës, pasi kulturë pa njerëz nuk kemi.

Kultura referuese, kryesisht e Perëndimit, është një shqetësim sot, për faktin se thjesht përdoret, por nuk jetohet nga të tjera kultura që e aplikojnë apo pretendojnë. Kjo hipotezë në dukje e çuditshme, pasi të bën të mendohesh paksa, mund të duket edhe e arsyeshme.

Ka mjaft që mendojnë se rriten me frymë perëndimore, janë perëndimore, por kjo është vetëm një veshje e jashtme e një ideje pa jetësi. Por, çfarë mendohet në përgjithësi rreth kulturës?

Robert T. Boyter, një historian në reticencë, mendon se kultura e organizatave dhe e korporatave është shumë e fortë mbi njeriun. Ajo krijon normat dhe rregullat të cilat edhe eliminojnë opoenencën. Kështu ngjarjet, observimet, arti, festivalet, edhe te më sekularët prej nesh, thotë ai, krijojnë trungun, madje edhe gjethet e pemës së kulturës.

Nga pikëpamja antropologjike dikush e përcakton kulturën si një mjet për t'iu ngjitur, bashkuar, një grupi. Kjo përfshin vlerat, standardet, besimin, gjuhën dhe gjithë gjërat e tjera të përafërta me grupin.

Shoqëria shikohet si një tjetër shpirt (anima) që merr e jep me kulturën, si një shumë totale e ndërveprimeve (mund të shtoja: e funksioneve); kultura përcakton se si njerëzit reagojnë, më në fund, ndaj gjërave që lidhen e nuk lidhen direkt me ta. Të gjitha këto arsytetime kërkojnë një përfytyrim fluid.

Në vazhdim të parantezës rreth topikut tonë, mund të hedhim një sy edhe te një koncept tjetër, ai i traditës dhe trashëgimisë: “diçka që vjen e të përket si arsye e lindjes në, që u trashëgua nga paraardhësit, që u përforcua si qëndrim yti, si zakon apo si informacion, apo si e vërtetë që ti beson”.

Por deri këtu ende jemi në një fushë gjurmimi se çfarë në tërësi sjell, përbën e ndan një kulturë prej një tjetre apo prej shoqërisë. Ende nuk jemi futur në skeptikën e çështjes, rreth asaj se dikush mund të përdorë një kulturë duke mos qenë i përputhur me të, duke e luajtur, duke e shfrytëzuar dhe duke mos e jetuar apo besuar si kulturë të vetën, pra thjesht duke e përdorur.

Këtu një koncept ndihmues, që mund të na hedhë pak dritë, është ai i civilizimit. Koncepti i civilizimit që krijuar për të treguar se më e larta vlerë e vlerave shfaqet te qëndrimi kundrejt “tjetrit”, pra se si sillemi me tjetrin, në mënyrë të qytetëruar apo jo.

Thuhet se shenjtëria e jetës në një madhësi të konsiderueshme varet tek e mira, etikja dhe e bukura. Atyre që u mungojnë këto veti, qenë shikuar si barbarë ose të paqytetëruar. Por përsëri edhe ky përcaktim nuk e shtron problemin e shtruar në debatin e filozofisë perëndimore në lidhje me kulturat e tjera, pra, ajo që aplikohet a jetohet apo thjesht përdoret?

Nëse për lehtësi kup-timi do t'i referoheshim fillimisht sistemit arsimor, mund të themi se një seri semantikash, domethënë aplikacionesh ideore, të cilat edhe i mësojmë dhe i përdorim në shkollë, nuk kanë vend në realitetin e marrëdhënieve përditore. Për shembull, për dy vjet studiova korporatat në nivelin master, por ende në vendin tim nuk pashe ndonjë jetë korporate apo bursë. Kështu një pjesë e

aplikacioneve mbeten varur mbi imagjinimin, pa krijuar një përfytyrim tangible me realitetin e jetës.

Në fushën e mendimit shoqëror në vendin tonë, kjo është e dukshme gjithashtu, pasi debati social, në përgjithësi dialogu, mbetet i lidhur me interesa; ende nuk kemi një pikëpamje a princip që të qëndrojnë mbi interesat dhe vlera, zakonisht, i referohet vetëm forcës në mënyrë të dukshme dhe të ndërrueshme.

Për sa i takon traditës së trashëguar, në tërësinë e saj ajo është familjare dhe ka një rit babai në të gjitha aktet e instancës mendore, që kërkon mbrojtje te diçka grupore; diskuri në tërësi, i palidhur me një interes imediat, apo grup, quhet pothuajse lajthitje.

Nuk kemi ende ndonjë traditë mendimi për kënaqësi mendimi. Ndoshta poezia është e vetmja fushë që ka bërë diçka për këtë formë joekzistenciale shprehjeje të ndërgjegjes sonë shoqërore.

Mungesa në tërësi e një rezonance publike nuk i jep amplifikim ndonjë vëzhgimi singular, madje edhe debati social, nëse mund ta quajmë të tillë, mbetet në një rreth shumë të ngushtë jo vetëm njerëzish, por edhe temash.

Kështu kultura matet, me sa duket, nga rrethi i padukshëm i shtrirjes së brendshme të formave kuptimore, të cilat janë imediate ose komplekse e të vonuara, pranuese dhe parakuptuese kundrejt tjetrit, ose refuzuese dhe agresive. Përdorimi i një kulture, i asaj perëndimore në vendin tonë, mund edhe të thotë se treguesit verbalë janë përmirësuar, por mbeten tjetër gjë dhe se sjellja njerëzore është tjetër. Ndoshta kjo është pika kyçe e keqpërdorimit të një kulture: që të thuash tjetër gjë e të veprosh tjetër, të çmosh teorikisht një vlerë dhe në praktikë ta diskriminosh atë, pikërisht pse përqafuesi i saj mund të jetë më i përgatitur se ti, domethënë, përjetues, jo përdorues.

Një kulturë, kur jeton veten, krijon atmosferë. Atmosfera është ajo që ndërton shpresat, pritshmëritë dhe piketat e aksionit.

Tradicionalisht, për efekt të historisë dhe pozicionit gjeografik, kemi bërë një jetë kulturore të tjetërsuar. Të jetosh në konceptin tënd dhe në kulturën tënde, ky ka qenë një privilegj i ndaluar për ne. Kështu më shumë se gjysmë shekulli jetuam në kulturën e komunizmit. Midis asaj që thoshim, mendonim dhe vepronim kishte një shpërputhje ekstreme, kur dihet se komunikimi i mirë është pikërisht përputhja e këtyre tri njësive. Nga kjo pikëpamje, zhvillimet tona janë kryer e deri diku vazhdojnë në përdorim kulture dhe jo në jetimin e saj.

Ndoshta një nga të drejtat e njeriut është përjetimi i kulturës së vet. Por jeta dhe aksioni social ndihen të tjetërsuar kur ecin në terma të ndryshëm, kur rrethi mental nuk i përshkohet shfaqjes verbale, kur veprimi dhe perifrazimi i tij kanë midis hendek të pakalueshëm.

Sigurisht, në terma linguistikë e gjithë kjo kontradiktë mund të shprehet si mospërputhje e gjuhës me kuptimin, si ecje e arsyes larg racionale (porcionit personal). Por mund të shihet edhe si një fasadë: një kulturë gjen veten në përdorim në një vend tjetër, kulturë, por kur afrohet për marrëdhënie konkrete prek zbrazëtinë e një realiteti të premtuar nga gjuha, poshtë termave të së cilës vepron një tjetër realitet dhe një rreth i panjohur mental. Ky nuk është thjesht një raport midis shoqërive. Sa vjen e më dukshëm ky diskord po bëhet prezent edhe mes njerëzve, të cilët me fjalë mbeten principalë, ndërsa me zemër janë inferiorë; potenciali gjuhësor tashmë para tyre është i lirë dhe mund të bënin të paktën një hap të vogël për të injoruar kushtet mentale (nëse ato nuk janë të kënaqshme), qoftë edhe nëpërmjet gjuhës. Asnjëherë njeriu nuk ka qenë më i pasur se sot dhe më i tiranizuar nga ideja e pamjaftueshmërisë së pasurisë. Ky inferioritet po ndihet në intrinsikun e të gjitha marrëdhënieve. Ndoshta ajo që duhet ndryshuar është thjesht dispozita. Disa, megjithatë, shikojnë anën e ndritshme të fenomenit dhe i jepen asaj. Ndoshta kjo është një mënyrë që kulturat dhe referenca e tjetrit të jetohet si e jotja, kur kënaqësia apo nevoja e kërkon.



EPITAF PËR VETEN

Ndoc Gjetja

LUTJE


O Zot, që fatet tona në dorë i mban
na ruaj nga shëndeti trashaman
na ruaj nga orekset e Sanço Pançes
na ruaj nga hija e rëndë e famës
na ruaj nga faqeputhjet helmuese të Judës
na ruaj nga orteku rrënimtar i turmës
na ruaj nga prejardhja prej shimpanzesë
na ruaj nga thyerja e timonit të kresë
na ruaj nga putra pushtetore e Njeshit
na ruaj nga engjëjt, na ruaj nga dreqërit
na ruaj përditë nga ftohja e miqësive
na ruaj, o Zot, secilin prej të gjithëve
unë ruhem vetë, o Zot, nga i ligu,
por ti më ruaj nga shoku dhe miku

DASHURISË

O perëndeshë e gjithëpushtetshme
e universit mashkull-femër!
Bëj ç’të duash me veten time
jam instrumenti yt i verbër.
Në jetë më solle kaq shumë dhembje
dhe shqetësime pa mbarim
po s’jam ankuar kundër teje
as me gojë e as me shkrim.

Të jam nënshtruar e të nënshtrohem
gjersa në botë të jem i gjallë
ndën pushtetin tënd të përbotshëm
më pëlqen të jem skllav

Ma ktheve gjuhën në përçartje
më bëre plak me shpirt fëmije
herë më hodhe qefinin krahëve
herë më ngrite gjer në yje.
Më hidh në zjarr, në det, në ferr!
Më hidh në baltë, më hidh në hon!
Veç të lutem mos më lër...
në atë vend ku ti mungon.



SIKUR

Ç’mrekulli do të kishte qenë
sikur të jepnin që sot dorëheqjen
presidenti dhe çdolloji ministri!
Dhe ta merrte pushtetin
Shpirti.

GJERGJ FISHTËS

Fort po shndrit e pak po nxeh
kjo e vërteta përmbi dhé!

Në politikën e gjithë krajlive
filli i lëmshit është lidhë nyje,
janë bërë një rrahja e puthja,
janë bërë një paqja e lufta,
janë bërë një tregu e miqësia,
janë bërë një burgu e liria,
janë bërë një gjoksi e shpina,
janë bërë një stomaku e zemra
në zgavër të gjoksit ka hyrë dhelpra
që e lot bishtin te buzëqeshja...

Shqipnia u kthye në Dreqistan
me plehra, smog e duf partish
në sofër të Atmes janë shtruar rrafshit
Palokë Cucat me tërë keqanat
që hanë e pinë me pare të pista
e Dedë Gjon Lulat lëpijnë pjatat...

Për ta gjetur të vërtetën
duhet sot t’i kthesh përmbys
disa mijë vargmale letrash
e çdo fjalë ta thyesh si arrën
mos ka brenda varrin tonë.
Por ballë për ballë me dhëlpërinë
na mos vdekshim me gungë në shpinë!
Ani se, ani se.

NJËSHIT

Në rendin e pafund të numrave të plotë
matematikisht, ti je më i vogli
por, ti papritur u bëre i madh
në saje të zerove që të shkojnë pas.

AH!

Ah, të kisha gëzime sa ç’kemi partira
Të kisha dhoma sa ç’kemi ministrira
Të kisha shokë sa ç’kemi shefa
Të kisha miq sa ç’kemi gazeta
Të kisha miksha sa ç’kemi vetura
Ah, të gjithë meshkujt të ishin burra
Të kishim njerëz sa ç’kemi banorë
Veç diellin lart të kishim epror.

GUVERNATORIT PONC PILATI

Zoti Ponc Pilati unë kam përshtypjen
Se vitet e fundit në guvernën tonë të varfër
Është shtuar përqindja e të sëmurëve psikikë
Dhe parashikoj një kataklizëm kombëtar
Prandaj me të ardhurat që vilen nga taksat
Shpenzoni pakëz për qetësimin e turmës.
Meqenëse Krishti nuk dihet kur kthehet
Hapni të paktën shtëpira publike.

EPITAF PËR VETEN

Këtu prehet ai që quhej Ndoc Gjetja
i cili pati ardhur gabimisht në botë
nga vetja e tepruar nxirrte vjersha
dhe gjithë njerëzit i quante shokë.

Kur pa që ëndrra kalkulohej me kompjuter
kur pa që idealet rrëzoheshin në kolltuqe
kur jepte buzëqeshje e merrte skërmitje
zuri sytë me dorë dhe vendosi të ikte.

Dhe shkoi e hyri në Manastirin e Unit
të shpëtonte shpirtin nga gjuhëligat e Lehjes
Pastaj e përcollën te banesa e fundit
me shpenzimet gratis nga Bashkia e Lezhës.

Në çastin e mbramë një hënë e përgjakur
e puthi në ballë dhe thirri: “Nënë”
Mos kërkoni të dini për të më tepër
se iku sikur të mos kishte qenë.

BUBURRECA E FATIT

Në çastin kur unë linda
Buburreca e fatit
Është nisur nga Himalaja
Që të arrijë një ditë
Te shtëpia ime.

Është nisur, e di

E di, që është nisur
Dhe po ecën, e di

E di, gjithashtu e di

Që do të vijë një ditë
Pas 7000 vjetësh.

ENCIKLIKË

Sot befas qielli i kujtesës m’u ça më dysh
dhe ndodhi para meje Zbulesa e Parë:
një univers i pasosur me rrëzëllime miqësish
të rroposura nga kataklizmi i ndarjes.

Përmes mjegullës dhjetëvjeçare të harresës
tash s’e kam vështirë të shoh ca fytyra miqsh,
që më patën pritur në oborr të Pilatit
në natën e gozhdimit tim në kryq.

O ish-shokë! O ish-miq! O të dashur ish-ër!
Po ju thërras sa trembem nga zëri im i çjerrë.
A e dëgjuat gjelin e profecisë pas mesit të natës
kur këndoi për të tretën herë?

E pra, profecia u bë: më humbët, ju humba,
ju humba, atje, në fund të kodrës së Kalvarit.
Vallë, a ju kujtohet ajo darka jonë e fundit
kur ju pata larë këmbët me duart e mallit?

Pas dyzet vjetëve, ju do të vini vëllezër
të më përqafohi tek Udha e Madhe e gjithë Mirësive,
por nuk do të më gjeni dot, mua, Shën Budallain
që ju pata dhënë dashuri të pakthyeshme.

Fragment nga romani "Pëllumbat i vrasin natën"

“PËLLUMBAT I VRASIN NATËN”

Virion Graçi



Neta ishte në ballkon duke dëgjuar pëllumbat. Unë, si zakonisht, isha duke fshirë këpucët ushtarake të tim eti, kur ra telefoni fiks. Nuk e ngrita telefonin t'i thosha: “Po, familja Taro jemi. Berti Taro jam. Kush jeni ju, ju lutem?” Bëra të kundërtën, e hoqa fishën e tij, e nxora jashtë funksioni. Mund të kisha shtypur një buton për ta fikur, por butonat janë defektozë, nganjëherë nuk kapin dhe të krijojnë mendimin përgjumës se ke kryer punë. Kur lustron këpucë, nuk do t'ia dish për zëra e zhurma që vërshojnë nga jashtë. Unë duke lustruar këpucë isha. Jo se jam prej profesioni lustraxhi, por lyej këpucët e prindërve të mi dhe të miat, sigurisht, prej dhjetë-pesëmbëdhjetë vjetësh. Ishte e rëndësishme për ne që endeshim kureshtarë rrugëve të Tiranës të kishe këpucë të rënda ushtarake, edhe kur moti ishte i ngrohtë, edhe kur ishin sandalet ose këpucët e lehta verore ato që e kishin radhën për t'u mbathur. Të shikojnë kureshtarët nga koka te këmbët për të të vlerësuar dhe në tablonë tënde të përgjithshme, diçka që e lë mangët koka, fytyra, gjoksi, kofshët, gjunjët, e korrigjon sakaq përshtypja e fortë që të lënë këpucët e rënda ushtarake. Fuqinë hipnotizuese të këpucëve të

rënda ushtarake nuk e dimë vetëm ne që kemi kryer punë të ndryshme në ushtri, por është kuptuar e përvetësuar nga popullata civile, pa dallim moshe e gjinie. Këpucët e mia, të reja, të papërdorurat, i pata shitur në një çast dobësie të një fshatar që kulloste lopët pranë repartit tim. I thashë babait se po vonohen me furnizimet e reja, kemi ngelur pa këpucë. Ai u habit e më pa me mosbesim, sepse në repartin e tyre, pak kilometra larg tonit, veshmbathjet ushtarake për gjashtëmujorin e ardhshëm ishin shpërndarë. Më premtoi se kjo punë do të zgjidhej shpejt dhe më trembi mendimi se mos vinte në komandën tonë për ta ngritur si problem parimor. S'pata kohë t'i thosha se bëra shaka, ose këpucët e reja i kam shitur, pasi ai, me tonin e kultivuar prej ushtaraku me përvojë, tha: “Nuk do të demoralizohemi për një palë këpucë, atdheu ka halle, do të gjejmë një mënyrë për të mos ngelur zbathur asnjëri prej nesh, kemi krijuar një bazë modeste familjare me sendet bazë për të tejkaluar vështirësitë.” Dhe nxori nga pluhuri dhe rrjetat e merimangave disa ish-këpucë me qafa të larta, me nga tri tokëza metalike secila.

- Jepi, - më tha, - silli në jetë dhe vishi si të ishin të tuat.

- Pse nuk do të jenë të miat? - i thashë.

- Të tuat, por janë në emrin tim në inventarin e repartit, - tha me të qeshur.


Kisha arritur me zor një paqe të brendshme ose, sikurse shprehem në zhargonin luftarak ne profesionistët, kisha ngritur flamurin e bardhë të armëpushimit duke u marrë me këpucët, duke përfytyruar repartin e babait duke u shkatërruar. Përfytyroja jo krejt repartin duke u shkatërruar, por depon me veshmbathje, vetëm depon. Madje, jo pikërisht depoja, por vetëm zyra e magazinierit. Sigurisht, jo krejt zyra e magazinierit, por vetëm shkresat e tij, dokumentet ku janë firmat e ushtarakëve që kanë tërhequr për përdorim vetjak veshmbathje, pajisje luftarake kundër armëve kimike dhe vaj për pastrimin e pushkëve. Me të tilla mendime të bukura jetoja, me flamurin e bardhë në mendje e në gjoks. Nuk doja të turbullohej që në mëngjes mendja ime, zemra ime. Pamja enigmatike e Netës pranë pëllumbave dhe format shprehëse, format rrëfimtare të këpucëve të vjetra ushtarake, më kishin futur në një ishull qetësie dhe ngrirjeje. Krejt ndryshe bota përqark, ziente prej ndryshimeve radikale, rënie të

regjimeve totalitare në Europën Lindore, përmbyse të regjimeve komuniste... pra: bajga lope atje, pleh cjapi këtu, jashtëqitje kuajsh, derrash aty më tej, glasa zogjsh në supet e njerëzve, mbi kapelat e tyre. Kështu thuhej: ndryshim, ndryshim, ndryshim.

Unë nuk isha pjesë e ndryshimeve, sepse nuk mund të bëhesha nga e para një njeri tjetër, një njeri i ri. (Eh, punë muti, do të ngelesha njeri i vjetër në regjim të ri shtetëror. E pashmangshme.) Kisha frikë të ndryshoja sepse, po të ndryshoja, do të kisha humbje të rënda ekonomike, nuk do të më vinin për shtat rrobrot që kam në shtëpi, këpucët mund të më vijnë të mëdha ose të vogla. Unë isha kundër ndryshimeve me ‘flamuj të bardhë’ në botë, në Europën Lindore, kundër vijës së re politike të Moskës, Uashingtonit, Londrës, Tiranës, duke valëvitur flamujt e bardhë. Po të më kishin pyetur, nuk do t'i kisha lejuar ndryshimet me këta lloj flamujsh. Doemos isha kundër drejtuesve të rinj në njësinë time bashkiake, kundër autoriteteve të vetëshpallura në lagjen time, kundër administratorit të porsaemëruar të pallatit tonë.

Gjithandej bajga, pleh, jashtëqitje bagëtish, glasa shpendësh grabitqarë. Po merrja masa për t'u konservuar, për të mos ndryshuar kurrë. KURRË. Por ishte e pamundur të konservoje vetveten dhe të ishte njeri i gjallë njëkohësisht, aq i gjallë sa fqinjët të të përshëndesnin kur shkëmbeheshe pashmangshëm me ta shkallëve, kurse administratori të të kërkonte mendime teknike për zgjidhjen e avarive në rrjetin e ujësjellësit, për shembull.

Fare pak mund të ndryshojë robi në faqe të dheut. Këtë bindje ma ftilloi edhe një i panjohur. Ai u shfaq para derës sime në kohën që porsa kisha dalë aty për kënaqësinë time dhe po sigurohesha të shtrëngoja lidhëset e këpucëve: njëra më varej përtokë, mund ta shkelja dhe të pengohesha, të rrëzohesha... I panjohuri ishte gati sa mosha ime, më tepër se njëzet vjeç, më pak se tridhjetë, me siguri. Dukej i hequr në fytyrë, rrudha të parakohshme ia rrethonin sytë, duart i kishte të ashpra, flokët të zinj e të dendur, si të mitë. Kishte veshur rroba të dala boje, mund t'i quaje edhe rroba pune, kominoshe, por ishin të lara, të porsaveshura, madje ndihej aroma e mirë që hedhim kohët e fundit nëpër lavatriçe. Ai mund të ishte shumëçka: punëtor riparim-shërbimesh, hidraulik, riparues televizorësh, lavatriçesh, frigoriferësh, kompjuterësh. Mund të ishte murator, suvatues, pllakashtrues ose bahçevan profesionist apo shpërndarës picash. Mund të ishte postier ose korrier i ndonjë partie të re politike, nga ata që shpërndajnë programe dhe literaturë në çdo shtëpi, megjithëse nuk rrezatonte optimizëm prej politikani. Nuk kishte nga ato shenjat që garantojnë optimizëm afatgjatë, personalitet të fortë, trashëgimi të lavdishme, sikurse janë veshmbathjet: këpucë, këmishë, rrip me origjinë ushtarake, këllëf pistolette etj. Përkundrazi, e kuqja dhe e gjelbra e ushtrisë sonë ishin ngjyra që ai nuk i kishte pasur ndonjëherë, atij i mungonin ato ngjyra. Në përfytyrimet e tij më të guximshme, në ëndrra nuk ka mundur t'i ketë dëshiruar të kuqen dhe të gjelbrën e ushtrisë sonë popullore.



PËR HERË TË PARË NË SHQIP “BRIGJE TË PIKËLLUARA” HISTORIA E PANJOHUR E SHQIPTARËVE NË TURQINË E VITEVE 1912–1923

Historia e panjohur e shqiptarëve në Turqi dhe fundi i Perandorisë Osmane, 1912–1923, i studiuesit amerikan Ryan Gingeras, përkthyer nga Virgjil Muçi, Botimet IDK

Filitet shumë për shqiptarët e Turqisë, por, në të vërtetë, për historinë e atyre dhjetëra mijëra syresh që emigruan në Anadoll mes viteve 1912-1923 dimë fare pak: Ç’ndodhi me ta pasi u vendosën në Anadoll? Pse autoritetet turke i shihnin me aq dyshim, duke mos i lejuar të vendoseshin në qytetet kryesore apo në zonat e konsideruara sensitive? Cila ishte qëndresa e tyre ndaj politikës së shpallur “për të shkukur me rrënjë gjuhën dhe zakonet e tyre”, që të ktheheshin në qytetarë besnikë turq? Bazuar kryesisht në hulumtimet e kryera në arkivat turq, studiuesi amerikan Ryan Gingeras na sjell një vepër mjaft të rëndësishme për këtë pjesë thuajse të panjohur të historisë. “Narrativa nacionaliste e historisë së Shqipërisë shmang enkas një nënndarje të rëndësishme të popullsisë: ata që thjesht hoqën dorë krejtësisht prej nacionalizmit shqiptar. Ky segment i kombit “imagjinar” shqiptar përfaqësohej në mënyrë të veçantë nga një numër i madh individësh që emigruan jashtë viseve shqipfolëse të Ballkanit Jugor dhe shkuan u vendosën gjetiu”. “Ndonëse në dukje nuk përbënin të njëjtin nivel kërcënimi vdekjeprurës për sigurinë e shtetit, si grekët dhe armenët, që në nenin e parë të talimname të vitit 1917 nënvizohej mosbesimi i përgjithshëm që ekzistonte ndaj shqiptarëve mbas krijimit të një shteti të pavarur shqiptar”.

Ryan Gingeras, aktualisht profesor në Departamentin e Çështjeve të Sigurisë Kombëtare në Naval Postgraduate School, SHBA, konsiderohet një ndër njohësit më të mirë të historisë së Turqisë, Ballkanit dhe Lindjes së Mesme. Autor i katër librave, ku mund të përmendim “Rënia e Sulltanatit: Lufta e Madhe dhe fundi i Perandorisë Osmane” (2014) dhe “Hero-ina, krimi i organizuar dhe bërja e Turqisë moderne” (2015). Libri i tij “Brigje të pikëlluara” ka marrë çmimet “Rothschild Book Prize in Nationalism and Ethnic Studies” dhe “British-Kuwait Friendship Society Book Prize”. Më poshtë botojmë parathënien e autorit Gingeras:

Në qoftë se gjërat do të thuheshin troç, ky punim doli në dritë falë një akti burracakërie. Ambiciet e mia, të cilat shkonin përtej provimeve, ishin të prirura për kah njëfarë projekti radikal, sfidues. Pothuajse e kisha mbledhur mendjen që disertacionin do ta shkruaja rreth ndonjë cepi të Anadollit gjatë Luftës së Parë Botërore dhe/ ose fillesave të Republikës Turke. Duke rrahur ta kap demin për brirësh, mora për nga Anadulli Lindor. Sakaq, m’u ndërmendën nja dy ide: ndoshta një studim se si qyteti i vogël i Naxçivan-it u bë pjesë e Azerbajxhanit; ca më mirë akoma, rindërtimi i Kars-it si rrjedhojë e krijimit të Republikës Turke. Të dyja tok, thashë me vete, hyjnë në punë që ç’ke me të. Por ja që miq e kolegë me një barrë përvojë në studimet osmane më paralajmëruan e më thanë se, në thelb, nuk po bëja gjë tjetër veçse do t’ia hiqja vetes profesionalisht. Pikësëpari, ishte çështja e burimeve. Ku do t’i gjeja? A



ekzistojnë vallë asi dokumentesh? Dhe çka ishte më e rëndësishmja, a do të më lejonin arkivistët turq të shihja dokumentet (një pyetje kjo që pasohej nga histori anekdotike tmerresh rreth studiuesve që u mohoheshin hyrja në arkivat shtetërore në Turqi)?

Paskëtaç vinin pasojat politike që duheshin pasur parasysh. Një disertacion që kishte të bënte me kurdët, armenët dhe subjekte të tjera që konsideroheshin tabu në Turqi, veçse do të më hapte telashe. Pavarësisht se çfarë kisha për të nxjerrë nga duart, më thanë, dikujt kishte për t’i mbetur hatri prej punës sime. Dikush tjetër, qoftë ai ndonjë ministër turk, pjesëtar i diasporës armenë ose ndonjë studiues osman, kishte për të më ngrënë me gjithë lecka, duke qenë se kisha sfiduar, mbështetur ose shpërfillur një sërë aspektesh të historisë së kohëve të fundit të Anadollit Lindor. Me pak fjalë, këshilla që më dhanë ishte kjo: mos e bëj. Mos e vrit karrierën tënde, pa filluar mirë. Përfundimisht, disertacioni që shkrova u ngrit mbi këtë këshillë. Koha e kaluar në arkiva më shtyu që të fokusohesha mbi Anadollin Perëndimor, si dhe tërhoqi vëmendjen time mbi rolin e luajtur prej emigrantëve shqiptarë dhe të Kaukazit Verior përgjatë Luftës për Pavarësi në Turqi. Përgjithësisht, kërkimet e bëra për këtë projekt shkuan si në vaj. Skenarët e makthshëm për të cilët isha paralajmëruar, nuk u vërtetuan. Nuk pati ndalime në jetë të jetëve. Nuk mora ndonjë letër gjithë mllef. Kurrëgjë. E megjithatë, nuk them dot me siguri se miqtë dhe kolegët e mi, njerëz që, në thelb, ma do mendja se më donin të mirën, gabonin. Po, arkivistët, studiuesit dhe punonjësit që takova në Stamboll dhe në Ankara ishin përnjëmend njerëz mjaft të sjellshëm, të gjindshëm dhe ngandonjëherë, ishte një

kënaqësi e vërtetë t’i kishe rreth e qark. Mjaft të zija ngoje dhe të shprehja interesin tim lidhur me emigrantët myslimanë në Anadoll dhe kjo gjë përshëndetej me një entuziazëm të çiltër e gjente mbështetje sakaq nga arkivistët, të cilët ndihmuan që hulumtimi im të bëhej i mundur. Sidoqoftë, rrallëherë e preka temën e armenëve dhe të grekëve me punonjësit e arkivave. Duke qenë se nuk përbënte diçka qendrore ku që fokusuar punimi im, fati paralel i jomyslimanëve në Anadollin Perëndimor gjatë viteve të luftës përbënte një subjekt që e mbaja të fshehtë. Këshillat e dikurshme gjëllnin ende në mendjen time. Kjo parathënie shërben si një apologji dhe shpjegim i tërthortë për vijueshmëritë dhe mosvijueshmëritë që vihen re midis disertacionit dhe këtij libri. Pyetja se çfarë ndodhi me grekët dhe armenët e Anadollit (por edhe me grupet e tjera të kriminalizuara) përgjatë viteve 1912-1923, vijon të peshojë edhe sot e kësaj dite si një gorillë 500-paundëshe mbyllur në një dhomë. Ngjarjet e kohëve të fundit, siç që vrasja e Hrant Dinkut, e vërtetojnë këtë gjë. Prapëseprapë, unë jam i mendimit se persekutimit të të krishterëve osmanë nuk mund t’i qasemi të izoluar. Për më tepër, rreth kësaj pike për mua është krejt e qartë se, përgjatë gjithë kësaj kohe, ka një histori më universale për të kallëzuar lidhur me nivelin dhe domethënien e vuajtjeve njerëzore në Anadoll. Siç do të qartësohet në faqet në vijim, modele të ngjashme të të arsyetuarit dhe të të sjellurit nga ana e qeverisë osmane, por edhe nga fuqitë pushtuese të Greqisë e vendeve të tjera, shpunë në zhvendosjen në masë, shfarosjen si të të krishterëve ashtu edhe të myslimanëve. Shkalla në të cilën bashkësi të ndryshme u viktimizuan nga trupat shtetërore që haheshin me njëra-tjetrën, doemos që ndryshon në mënyrë të papërfytyrueshme (në qoftë se do të shtrëngohesha të bëja një krahasim, atëherë është më se e qartë se, aty nga viti 1923, armenët dhe grekët së toku zinin një pozitë shumë herë më pak të lakmueshme sesa emigrantët myslimanë). Në qoftë se dikush merr të krahasojë nivelin e vuajtjeve, kjo nuk ka të bëjë me punën tonë. Përkundrazi, ky libër shtron pyetjen dhe merret saktësisht me faktin se përse, vallë, dhe në ç’masë grupe të mëdha njerëzish që jetonin rreth e qark brigjeve jugore të detit Marmara iu nënshtuan një sërë fushatash që synonin t’u bënin keq. Për të ndriçuar më mirë unanimitetin e vuajtjeve të zbuluara në gjirin e bashkësive të ndryshme që jetonin rreth e qark brigjeve jugore të detit Marmara, e vura theksin kryesisht mbi çështjen armenë dhe atë greke. Edhe pse nuk kam kurrfarë dyshimi për këtë gjë, unë besoj se këta hapa vijnë në ndihmë për të ngushtuar hendekun historik midis të krishterëve vendas dhe myslimanëve të ardhur, madje shumë më mirë se orvatja ime e mëparshme. Ndonëse teksti që vijon nuk është këqyruar si një punim krahasues, mund të thuhet se historia e Anadollit përgjatë kësaj periudhe kohore nuk është diçka unike në kuptimin global. Diskriminimi në masë dhe likuidimi i popullsisë vendase është një fenomen që mund ta pikasësh kudo nëpër botë. Terrori shtetëror i kësaj natyre është një dukuri moderne dhe si e tillë, është pjesë përbërëse e logjikës moderne të shtetndërtimit. Duke e vendosur këtë studim brendapërbrenda një rajoni të caktuar, si dhe duke iu qasur një mase të qartë e të përcaktuar njerëzish, unë shkoj e ndërmarr disa koncepte të ngjeshura, historike dhe, siç pranohet përgjithësisht, tejet kritike: modernizimi i shtetit, dhuna e organizuar, formimi i identitetit, emigracioni dhe rrjetet e politikës. Duke e kufizuar punimin tim, si nga ana gjeografike ashtu edhe sociale, shpresoj që ta bëja më të manovrueshëm diskutimin e gjithë këtyre fijeve të larmishme historike, ndërsa narrativën sa më të padukshme. Duke hedhur sytë pas mund të them se nuk më vjen keq që shkova dhe ndoqa këshillat e kolegëve të mi të besuar. Tek e fundit, unë e ndiej se më kanë shpënë pas për të shtjelluar objektivat e mi zanafillorë. Gjithsesi, shpresoj se të tjerë njerëz (që e kanë lëkurën më të trashë se timen) kanë për t’u marrë me historitë e Kars-ës dhe të Naxçivan-it, si dhe ngjarje të tjera me peshë për t’u kallëzuar.

Botimet Françeskane risjellin “Kanuni i Skanderbegut”, mbledhur e kodifikuar nga Imzot Frano Ilia në vitin 1993. Kanuni shoqërohet me një paraqitje nga Imzot Angelo Massafra, arqipeshkëv metropolitan i Aqipeshkvisë Shkodër-Pult

BOTOHET “KANUNI I SKANDERBEGUT”, MBLEDHË E KODIFIKUE NGA IMZOT FRANO ILIA

nga Imzot Angelo Massafra*

Idealet e klerit katolik shqiptar për Fe, Kulturë dhe Atdhe nuk mbetën vetëm në planin teorik, por ndërtuan një mënyrë të mirëfilltë jetë për ripërtëritjen shpirtërore dhe kulturore të vetë popullit. Klerikët katolikë qenë idealistë që nuk u tërhoqën kurrë nga ideali i tyre. Ata nuk bënë asnjë lloj kompromisi me të keqen në dëm të besimit apo të atdheut. Për këtë arsye, mund t’i quajmë edhe yje që ndriçojnë në qiellin e kulturës shqiptare.

Mbledhja e traditave, e ligjeve dhe e zakoneve ka filluar prej tyre qysh herët. Dallojmë këtu në mënyrë të veçantë Atë Shtjefën Gjeçovin, Atë Bernardin Palajn, Atë Donat Kurtin, Dom Lekë Sirdanin dhe Imzot Frano Ilinë, paraardhësin tim në Arqipeshkvinë e Shkodrës.

Tradita e shkrimtarëve katolikë të Veriut e kishte kuptuar se për të njohur identitetin e popullit, më parë duhet të njohim historinë e tij. Këtë projekt të

mirëfilltë kulturor e shpjegon më së miri Atë Pal Dodaj në ditarin e tij: “Për mue, detyra ma e saktë e atij që merret me literaturën në Shqipëri, do t’ishte mos me u shpëputë – sa ma shumë t’i jetë e mujtun – nga shpirti i popullit dhe me iu përmbajtë formave popullore, tue fisnikëruë, por pa i shtrembnue. Kjo do të bahet sa herë do të kërkohet nga njena anë të depërtohet e të zbulohen mendime, ndjenja që karakterizojnë popullin tonë; e nga ana tjetër, mos me u largue nga mënyrat e elokuencës popullore. Vetëm kështu, simbas mendimit tem, do të mund të përmbushet dalëngadalë evolucioni ynë letrar në rrugë progresive. Në rast se veprohet ndryshe, procesi ka për t’u krye me hope, me rrezikun që breznitë e ardhshme kanë për t’u shtrëngue me ba hapa mbrapa.”

Nëse analizojmë këtë pohim të fratit të njohur, dallojmë në të një program të qartë veprimi, të cilin e aktualizuan meshtarët e Kishës Katolike në vendin



tonë. Me të drejtë, pas kaq vitesh shohim se këto ishin parime të drejta që udhëhoqën etërit e shquar të Kishës Katolike në Shqipëri për të ruajtur traditën dhe kulturën e popullit e njëkohësisht për të na e transmetuar atë përmes veprave të tyre. Nëse nuk do të kishim sot në dorë thesare, si: *Kangët e kreshnikëve* mbledhur nga Atë Bernardin Palaj e Atë Donat Kurti, *Kangët gegnishte* të Imzot Vinçenc Prennushit, *Kanunin e Lek Dukagjinit* të Atë Shtjefën Gjeçovit, *Fjalët e urta dhe Frazologjitë popullore* të Dom Aleksandër Sirdanit, *Prrallat Kombtare* të Atë Donat Kurtit, *Skandërbegun mbas gojëdhana*sh të Atë Marin Sirdanit e sa e sa vepra të tjera, kultura shqiptare do të ishte shumë e varfër. Ne nuk kemi nevojë të bëjmë hapa prapa, sepse punën e kanë bërë paraardhësit tanë. Na duhet vetëm t’i vlerësojmë etërit françeskanë, ata jezuitë dhe meshtarët dioqezanë për angazhimin dhe punën e tyre.

Mendoj se duhet t’i studiojmë pareshtur për të përmirësuar kulturën e sotme. Edhe pse janë kontribute të shkruara para shumë kohëve, ato janë ende shumë të vyera dhe ne jemi të vetëdijshëm se kultura e sotme pa këto tekste do të ishte e mangët.

Ribotimi i *Kanunit të Skanderbegut* pas shumë kohësh është një vlerë e shtuar për kulturën juridike, dokesore e historike të popullit shqiptar. Vepra *Kanuni i Skanderbegut*, sipas parathënies dhe sipas dëshmimeve gojore të vetë autorit, ka kaluar kalvare të shumta nëpër arkiva, derisa pa dritën e botimit në vitin 1993.

Ky ribotim risjell punën e madhe e shumë të çmuar të Imzot Frano Ilisë. Ai që dënuar me vdekje si spiun i Vatikanit, dënim që ia kthyen në njëzet e pesë vjet burg e punë të detyruar. Kaloj shumë vjet në burgje dhe u persekutua si shumë klerikë të tjerë, por i qëndroi besnik fesë dhe punoi për atdheun edhe në vuajtje, mjerime e skamje. Megjithatë, puna e tij nuk ka shkuar dëm, por është vlerësuar dhe po vlerësohet përmes kësaj vepre.

Prandaj kam qenë i gatshëm t’i jap leje Provincës Françeskane “Zoja Nunciatë” që ta ribotojë *Kanunin e Skanderbegut* të Imzot Frano Ilisë, sepse ka kohë që nuk gjendet më për lexuesin shqiptar. Kjo vepër botohet në formë anastatike duke u shërbyer jo vetëm studiuesve të gjuhës shqipe, të ligjeve dhe të traditave shqiptare, por edhe lexuesit të thjeshtë.

Uroj që leximi i kësaj vepre të shërbejë për të shpalosur edhe më tej historinë dhe mendësinë e popullit shqiptar, si edhe për të vlerësuar edhe më shumë punën dhe mundin e derdhur të autorit, Imzot Frano Ilisë, i cili hyn tashmë në vargun e personaliteteve të shquara të klerit katolik në Shqipëri.

Arqipeshkëv Metropolit i Shkodër-Pult



KANUNI i Skanderbegut

“

Mbledhja e traditave, e ligjeve dhe e zakoneve ka filluar prej tyre qysh herët. Dallojmë këtu në mënyrë të veçantë Atë Shtjefën Gjeçovin, Atë Bernardin Palajn, Atë Donat Kurtin, Dom Lekë Sirdanin dhe Imzot Frano Ilinë, paraardhësin tim në Arqipeshkvinë e Shkodrës.

KINEMATOGRAFIA NË KOSOVË NË MES TË AMBICIEVE DHE (PA)MUNDËSISË FINANCIARE

nga Gani Mehmetaj

Kinematografia e Kosovës në dhjetëvjetëshin e fundit veçohet me hapjen e dukshme ndaj bashkëprodhimeve e bashkëpunimeve ndërkombëtare, me pjesëmarrjen në festivale ndërkombëtare, me përpjekjet për të komunikuar me shikuesit e huaj. Ka më shumë se asnjëherë më parë kineastë të rinj, disa prej të cilëve janë premtues, me ambicie dhe kulturë filmi. Projektet kinematografike realizohen me buxhet të vogël, më të voglin në rajon, prandaj dramat urbane që janë në mes të filmit artistik e dramës televizive nuk janë të pakta; meqë nuk kërkojnë shpenzime të mëdha, bëhen me ekipe të vogla xhiruese e me pak aktorë. Llojet e filmave (zhanret) janë nga më të ndryshmet: drama, komedi, filma psikologjikë, filma aksioni etj. Filmat më të kushtueshëm kryesisht janë realizuar nga regjisorët e vjetër me një përvojë më të gjatë në film. Mjetet që jepen për kinematografi janë më të paktat në Gadishull. Të gjithë konkurrentët në konkursin publik marrin nga pak, ndërsa asnjëri nuk është i kënaqur, sepse asnjëri nga producentët, po nuk gjeti mbështetje tjetër, nuk mund të përthejë as gjysmën e shpenzimeve për projektin.

Kinematografia e Kosovës është kinematografi e vogël. Asnjëherë nuk është shquar për ndonjë prodhimtari të madhe, ndërsa ka bërë përpjekje të ngulmëta të dalë nga izolimi rajonal dhe të komunikojë me botën. Disa nga këta filma kanë marrë pjesë në qindra festivale ndërkombëtare, janë kthyer me çmime. Megjithatë deri para ndonjë viti nuk pati stimulim apo buxhet të veçantë për pjesëmarrjen e filmave në festivale ndërkombëtare, ishin producentët e regjisorët, apo ndonjë mbështetje ndërkombëtare, që i mbulonin shpenzimet.

Filmi dokumentar dhe ai i animuara sikur janë lënë anash, janë më të paktë sesa filmi artistik i gjatë dhe ai i shkurtër. Është e habitshme se si edhe brezi i ri ngurron të kultivojë filmin dokumentar e të animuar.

Filmat kryekëput i financon shteti – Ministria e Kulturës përmes Qendrës Kinematografike me konkurse publike, – ndërsa televizionet nuk marrin pjesë as në mënyrë simbolike në financime, edhe pse kanë aq pak programe origjinale artistike.

Problem të veçantë për shfaqjen e filmave teshikuesit vendës paraqet mungesa e kinemave, sallat e vjetra mbi gjashtëdhjetëvjeçare. Gjatë fazës së privatizimit, një pjesë e këtyre kinemave e kanë ndryshuar veprimtarinë kryesore, të tjerat janë një përzierje e pronës publike, pa mirëmbajtje të duhur dhe pa leje që të punojnë në parimin e ligjeve të tregut. Agjencia e privatizimit u rri mbi kokë, as nuk i privatizon, as nuk i lejon të punojnë të pavarura. Nga 33 kinematë e dikurshme që



shfaqnin rregullisht filma dhe 20 kinemave shëtitëse, kanë mbetur katër-pesë kinema funksionale, ndërsa të tjerat shfaqin filma nga rasti në rast. Filmat artistikë të vendit a bashkëprodhimet me shtetet e rajonit apo të Europës Perëndimore nuk e kanë shikueshmërinë e dikurshme, sepse pjesa më e madhe e tyre gjatë fazës së privatizimit e kanë ndryshuar destinimin, ose nuk shfaqin filma fare.

Sistemi i kinemave multiplekse që ka filluar ta mbulojë territorin e Kosovës është i natyrës së

veçantë. Jo të gjithë filmat artistikë të vendit shfaqen në të dhe jo të gjithë janë për këtë rrjet të kinemave. Sipas parimeve të ligjeve të tregut, asnjë film të ne nuk i mbulon shpenzimet me shfaqje në kinema. Ky problem është problem i kinematografive në tërë Gadishullin Ballkanik, mirëpo te ne është më i shprehur se kudo tjetër. Televizionet qendrore e shfaqin me shumë ngurrim filmin e vendit, ose paguajnë aq pak sa nuk vlen të jepet leja për shfaqje, meqë mund ta dëmtojë pastaj shfaqjen në sistemin e portaleve me pagesë.

Në dhjetëvjetëshin e fundit dy herë janë bërë përpjekje të plotësohet e të ndryshohet Ligji për Kinematografi (2004), mirëpo interesat e ndryshme dhe mospajtimet në mes të kineastëve e zyrtarëve të shtetit kanë ndikuar që ligji të mos plotësohet.

Do të bëjmë një paraqitje telegrafike të filmave më karakteristikë të produksionit të Kosovës, që u shquan me qasjen ndryshe, me temat e tyre, specifkat e jetës urbane dhe me ngulmimin për identitet.

Filmi “Babai”, sipas skenarit e regjisë së Visar Morinës (arsimimin filmik e ka mbaruar në Gjermani), është ndër filmat më të veçantë dhe më të suksesshëm në dhjetëvjetëshin e fundit që u shfaq, pos në festivale ndërkombëtare, edhe në rrjetin e kinemave gjermane.

Autori i ri Visar Morina, përmes fatit të babait e të birit, paraqet atmosferën e dhunës dhe varfërinë e skajshme në Kosovë në dhjetëvjetëshin e fundit të shekullit XX. Në përpjekje për të ikur nga varfëria dhe nga dhuna policore, protagonistët e filmit nuk kalojnë më mirë as si refugjatë në Gjermani. Përkundrazi, zhgënjehen pas shumë peripecive që përjetojnë. Filmi “Babai”, me dendësinë e emocioneve, kthesat e papritura dhe zymtësinë e atmosferës, s’është lehtë të qetë, të mban pezull, ndërsa të nxit në përsiatje edhe një kohë të gjatë pasi të kesh dalë nga salla e kinemasë. Protagonistët, Nori (në interpretim të vogëlushit Val Maloku), Gëzimi (babai Astrit Kabashi), kalojnë nëpër peripeci e trauma. “Babai” ka atmosferë të neorealizmit italian, të asaj fryme që të mbërthen në vaje dhe të lë shijen e hidhur të jetës së rëndë, është i realizuar me mjeshtri e invencion. Filmi është bashkëprodhim i “NikoFilm” (Gjermani), produksioni “Krusha” (Kosovë), “Skopje Film Studio” (Maqedoni) dhe “Eaux Vives Productions” (Francë). Mori katër çmime në festivalin e madh “Filmfest Munchen”, ndërsa në “Karlovy Vary” u laureua me çmimin për regjinë më të mirë, si dhe çmimin “Europa Cinemas Label”, që jepet nga “Europa Cinemas Network”.

“Gomarët e kufirit”, sipas skenarit të Jeton Nezirajt dhe regjisë së Jeton Ahmetajt, është dramë që paraqet ndërthurjen e fateve të banorëve të një katundi kufitar. Ngjarja ndodh në fund të viteve gjashtëdhjetë të shekullit të kaluar. Katundarë, ushtarakë, policë dhe kureshtarë sillen në një rreth të mbyllur, ndërsa është një mësues idealist i cili më së voni këndellet. Ka në





këtë film situata tragjikomike, humor të zi, por edhe metafora politike. Interpretojnë Shkumbin Istrefi, Florentina Ademi, Hysen Binaku, Luan Daka, Hazir Haziri.

Ndërkaq, “Heroi” i Luan Kryeziut, autor i skenarit dhe i regjisë, me aktorët: Arben Bajraktaraj, Adriana Morina, Çun Lajçi, Salahudin Bilali, Enver Petrovci, Xhemi Aga etj., është ndryshe nga filmat e tjerë për luftën e fundit. Ai trajton fatin e luftëtarit, gjendjen sociale dhe zhgënjimin, sepse askush nuk e kupton dhe nuk përpiket ta ndihmojë atëherë kur ia ka nevojën shoqërisë. Në vend të mirënjohjes, e pret përbuzja e shpërfillja. Filmi është pritur mirë nga opinioni me qasjen e ngrohtë që ka ndaj personazheve dhe me përpjekjet për të fshikulluar shoqërinë e korruptuar dhe realitetin e hidhur.

Regjisori me përvojë Agim Sopi (*Njeriu prej dheu, Lulëpeshkat e dashurisë, Kulla, Përtej vdekjes, Vjeshta e trëndafilave, Anatema* etj.) në filmin “Agnus dei” merret me luftën e fundit, të trajtuar nga prizmi i dramës kolektive dhe fateve individuale. Duke ndjekur peripecitë e dy të rinjve të cilët lufta i afron, por përkatësia kombëtare i armiqëson, regjisori pastaj ndërthur fatin e tyre, duke e nxjerrë incestin si lajtmotiv. Mbi incestin ndërtohet tragjedia e tyre e dyfishtë. “Agnus dei” është filmi më i shfaqur i Kosovës në festivale ndërkombëtare dhe filmi që mori më së shumti çmime ndërkombëtare. Interpretuan: Astrit Alihajdaraj, Dafina Berisha, Zaklina Ostir, Enver Petrovci, Çun Lajçi, Bajrush Mjaku.

“Tri dritare dhe një varje”, në regji të Isa Qosjes (*Proka, Rojat e mjegullës, Kukumi*), me skenar të Zymber Kelmendit, drejtor i fotografisë ishte Gökhan Tiryaki, kameraman i regjisorit të njohur turk Cejlan, për dallim nga shumica e filmave tanë të luftës, vetëm shkarazi i referohet luftës, ndërsa përqendrohet në pasojat. “Tri dritare dhe një varje” nxjerr në pah katundin e varfër dhe të braktisur, ku heshtja dhe përpjekja për të fshehur të kaluarën është makth për të gjithë. Në çastin kur del e fshehta e grave të përdhunara, pasi njëra nga to i jep një intervistë gazetarit të huaj, nis histeria e linçimit të asaj që e nxjerr këtë temë tabu. “Tri dritare...” e përfaqësoi Kosovën në konkurrimin për “Oscar”. Aktorët kryesorë: Irena Cahani (Lushe), Luan Jaha (Uka), Donat Qosja (Sokol).

Brezi i kineasteve të reja

Lendita Zeqiri, Blerta Zeqiri, Arzana Kraja e Burbuqe Berisha, janë katër emra të rinj të regjisorëve shqiptarë të Kosovës. Disa prej tyre në filmat e parë të metrazhit të shkurtër korren suksese edhe jashtë vendit, si Lendita Zeqiri me filmat “Ballkoni” e “Gardhi”, një qasje ndryshe që u prit mirë dhe mori çmime në festivale ndërkombëtare. Me filmin tjetër,

“Aga”, dramë për gratë e keqtrajtuara dhe të dhunuara që pastaj i ngrysin ditët në një azil, Zeqiri nxjerr në pah gjendjen tragjikomike të kësaj kategorie sociale. Janë dialogët e dendur që rrjedhin pa pra, me lëvizje të shpejta të kamerës, ato që i portretizojnë karakteret dhe paraqesin mjedisin ku jetojnë, nxjerrin në sipërfaqe fatet e tyre, por, megjithatë, gjejnë forcë të tallen, të tregojnë rrëfime, të ndërtojnë një jetë të re. Filmi ka një qasje interesante, degëzim të rrëfimit dramaturgjik, portretizim të mirë të personazheve.

E motra, Blerta Zeqiri, me filmin “Martesa”, ku është edhe skenariste me Kreshnik Berishën, jo vetëm që solli temë të veçantë me atmosferë të veçantë, por theu disa tabu tradicionale, nxori në sipërfaqe temën për debate që e bënë filmin me atraktiv. Regjia ishte dinamike, karakteret e portretizuar dhe të realizuar. Përmes mjedisit urban, kafeneve, muzikës, dasmës jokonvencionale, paraqitet jo vetëm mendësia, por edhe frustrimet, traumat, konfliktet me mjedisin, ndërsa të gjithë janë të frustruar, dikush më shumë e dikush më pak. “Martesa” ndryshon shumë nga filmat e tjerë të Kosovës. Interpretojnë Alban Ukaj, Adriana Matoshi, Genc Salihu. Bekimi, Anita dhe Noli janë personazhet që krijojnë një trekëndësh të çuditshëm: ajo e dashuron Bekimin, Bekimi e dashuron Nolin, ndërsa Noli prapë e do Bekimin. Alban Uka në këtë film shquhet me një interpretim dinamik e ekspresiv. Adriana Matoshi është një emër tjetër i filmit në Kosovë, e veçantë për mënyrën e interpretimit, sharmante me figurën, farfuritëse me buzëqeshjen, e këndshme për ekran.

Arzana Kraja, regjisore dhe skenariste e filmit “Fusha e mëllenjave”, një rrëfim dramatik për fatin e fatkeqësinë e ish-të burgosurve që nuk gjejnë prehje, trajton një temë që nuk është e pranishme në kinematografi. Sylja, një ish-i burgosur politik, pas

njëzet vjetësh kthehet në vendlindje për të kapur fjetet e humbura të jetës së tij të dikurshme. Londra, që ia rikthen të kaluarën, bëhet makth e torturë, prandaj kthehet aty ku e nis jetën që iu këput në mes.

“Një tregim Prishtine”, në regji të Burbuqe Berishës e skenar nga Getoarë Mulliqi Bojaj, mund të quhet edhe një rrëfim për Kosovën e pasluftës, kur varfëria, dëshpërimi, krimi i organizuar dhe korrupsioni mbizotërojnë mbi vlerat e qytetërimit. Drama sociale del në plan të parë, por korrupsioni dhe krimi janë lajtmotiv i filmit. Edhe vrasjet e krimit të organizuar dalin në pah. Rolet kryesore i interpretojnë Teuta Krasniqi, Donat Qosja, Luran Ahmeti, Artiola Hamdijaj.

Dramat urbane, vetmia

“Qiejll i trazuar”, regjia e skenari Anton Ndreca, me Jehon Goranin, Arta Muçajn, Imer Kutllovcin etj., është një qasje interesante në mjedisin urban. Një familje moderne nuk ka probleme ekzistenciale, por e mbërthen sëmundja e së sotmes, raportet e komplikua ndërnjerëzore. Babai vuan nga depresioni dhe kotësia e jetës si pasojë e përsiatjeve filozofike, djali bëhet narkoman ngaqë ndihet i braktisur, kurse vajza bëhet lesbike, sepse ashtu e ndien veten më mirë. Është nëna ajo që përpiket t’i lidhë fjetet e këputura të marrëdhënieve në familje, por që, njëkohësisht, ajo është e infektuar nga sëmundja moderne, ambiciet për karrierë.

“T’padashtun”, regjia dhe skenari të Edon Rizvanollit, me Adriana Matoshi, Jason de Ridder, Niki Verkaar, është film që pjesën më të madhe të ngjarjeve e zhvillon në Perëndim, atje ku jetojnë nëna me djalin, të ikur nga Kosova. Arsytet e ikjes shpalohej më vonë, që janë po aq dramatike. Ndërkaq vetminë e braktisjen i përjeton djaloshi i cili kapërcen nëpër fazën kritike të adoleshencës. Vetmia në mjedisin urban është temë trajtimi e këtij filmi me një qasje të ngrohtë. Djaloshi nga Kosova me vështirësi inkadrohet në Amsterdam, ndërsa nëna, refugjate që ikën për t’iu shmangur një drame tjetër, fsheh një të kaluar të dhimbshme...

Për filmin “Shok”, me regji nga Jamie Donoughue, u fol dhe u shkrua shumë. Filmi i bashkëprodhimit britaniko-kosovar, i mbështetur në ngjarje të vërteta nga viti 1998, ishte filmi i parë nga Kosova që kandidonte ndonjëherë për një çmim “Oskar”. Është filmi më i mirë dhe më tronditës për luftën 1998-1999 në Kosovë, që të shokon. Dramatik, i drejtpërdrejtë, i ashpër, emocional, goditës e fshikullues, me kuadro të shpejta, të lidhura mirë dhe me një ritëm që të mban pezull. “Shok” është filmi që e kërkuam me ngulm. Me të drejtë, ishte në rrethin e ngushtë për çmimin “Oskar”, por, fatkeqësisht, nuk fitoi.

Ndërkaq, kur ta kesh shikuar filmin “Kolona”, një ndjenjë e vrasjes së ndërgjegjes të mbërthen sikur të ishte protagonist, ai që duhet të vendosë për jetën e vdekjen e dy adoleshenteve, e jo policët ata që i ekzekutojnë.

*Autori është drejtor i “Kosovafilmit”, skenarist e profesor në Fakultetin e Arteve Mediale në Prishtinë.



Për Servantesin si njeri dimë shumë më tepër sesa për Shekspirin, por, me sa duket, kemi ende për të mësuar, sepse jeta e tij ishte e rrëmbyer, e mundimshme dhe heroike. Si dramaturg, Shekspiri përjetoi një sukses të stërmadh financiar dhe vdiq i kamur, me ambicie shoqërore (sikundër qenë) të përmbushura. Me gjithë popullaritetin e *Don Kishotit*, Servantesi nuk gëzoi frytet e së drejtës së autorit dhe s'pati fat me pajtorët. Kishte disa ambicie realiste, përmbushja e të cilave zor se mund t'i siguronte mëngojën. Si dramaturg që një dështak. Nuk ishte i darovitur me dhuntinë poetike; *Don Kishoti* po, ishte dhuntia e tij. Bashkëkohës i Shekspirit (vdiqën, sikundër thuhet, në një ditë), ai ka të përbashkët me Shekspirin universalitetin e gjenisë së tij dhe në Kanonin Perëndimor është i vetmi që mund të përqaset me të dhe Danten.

Ka nga ata që e shprishin këtë radhë dhe që mëtojnë se këtë treshe e përbëjnë Servantesi, Shekspiri e Montenji, meqenëse që të tre janë shkrimtarë të urtë; nuk ka një të katërtë kaq me mend, kaq të mirë, pos Molierit që, në njëfarë kuptimi, është Montenji i rilindur, por në një zhanër tjetër. Sipas mendimit të ndoca të tjerëve, vetëm Servantesi dhe Shekspiri qëndrojnë në majën më të epërme; ata nuk mund t'i kalosh, sepse janë gjithmonë përpara.

I gjendur përballë fuqisë së *Don Kishotit*, lexuesi në asnjë rast nuk picërrohet, ai vetëm sa madhohet. Kjo nuk ndodh gjithmonë me leximin e Dantes, Miltonit apo të Xhonatan Suiftit, *Përralla e fuqisë* e të cilit më ka prekur gjithnjë si proza më e mirë në anglisht, pas prozës së Shekspirit. Nuk ndodh as me leximin e Kafkës, shkrimtarit qendror të kaosit tonë. Shekspiri është sërish i ngjashmi më i afërt i tij; këtë pohim e mbështesim në kapacitetin e pafundmë të dramaturgut për çinteresimin. Ndonëse Servantesi nuk lë gjë pa bërë për t'u dukur katolik i devotshëm, ne, megjithatë, nuk e lexojmë *Don Kishotin* si një vepër të përshpirtshme. Me gjasë, Servantesi ishte një i Krishterë i Vjetër dhe jo një i konvertuar rishtazi a, sikundër quheshin, një

SERVANTESI: LOJA E BOTËS

nga Harold Bloom

i Krishterë i Ri, ndonëse nuk mund të jemi krejt të sigurt për origjinën e tij, ashtu siç nuk mund të marrim saktësisht me mend qëndrimet e tij. Të përshkruash ironitë e Servantesit është një gjë fare e pamundur; të mos i vëresh ato, gjithaq e pamundur.

Ndonëse kishte luftuar heroikisht (ai humbi përgjithnjë aftësinë e përdorimit të dorës së majtë në betejën e madhe detare të Lepantos kundër turqve), Servantesi duhet të bënte sytë katër e të ruhej si nga Kundërreformacioni, ashtu edhe nga Inkuizicioni. Trajtat e ndryshme që merr marrëzia e Kishotit i siguruan, si personazhit ashtu dhe Servantesit vetë, një lloj patente marrëzie, pak a shumë si Lolos të *Mbreti Lir*, vepër kjo që u vu në skenë në po atë kohë kur u botua edhe pjesa e parë e *Don Kishotit*.

S'ka dyshim që Servantesi ishte dishepull i Erazmit, humanistit holandez, shkrimet mbi brendësinë e krishterë të të cilit grishën gjerësisht të konvertuarit, të ngecur midis një judaizmi të cilin patën qenë të

shtrenguar ta braktisnin dhe një sistemi të krishterë që i katandiste në qytetarë të dorës së dytë. Familja stërgjyshore e Servantesit ishte e mbushur me mjekë, profesion ky mjaft popullor në mesin e hebrenjve të Spanjës, përpara dëbimeve e konvertimeve të detyrueshme të 1492-it. Duket se edhe një shekull më vonë Servantesi u druhet ende përndjekjeve finoke të atij viti të tmerrshëm që u shkaktoi aq shumë andralla hebrenjve e maorëve, si dhe mbrothësisë ekonomike të Spanjës.

Duket sikur nuk ekzistojnë dy njerëz që të lexojnë të njëjtin *Don Kishot* dhe kritikët më të shquar nuk kanë mundur të pajtohen për shumicën e tipareve thelbësore të librit. Erih Auerbahu mendonte se libri ishte i pashoq për sa i përket pasqyrimit të realitetit të përditshëm si një gëzim i vazhdueshëm. Megjithatë, as tani që sapo kam përfunduar së rilexuari *Don Kishotin*, nuk jam në gjendje të kuptoj atë që Auerbahu e quan "një gëzim universal, kaq kritik

e joproblematik".

Termat "simbolikë e tragjikë", edhe kur përdoren për të kategorizuar marrëzinë e heroit, Auerbahut i dukeshin të pasaktë. Kundër këtij mëtimi vë më të mprehtin e më kishotianin ndër kritikë, njeriun bask të letrave, Migel de Unamuno, "ndijimi tragjik i jetës" së të cilit mbështetej në marrëdhënien e tij të ngushtë me kryeveprën e Servantesit, që të zëvendësonte Biblën si një Shkronjë autentike spanjolle. "Ynzot Don Kishoti" e quante Unamunoja, një kafkian përpara Kafkës, ngaqë marrëzia e tij rrjedh nga besimi në atë që Kafka do ta kishte quajtur "pashkatërrueshmëri". Kalorësi i Fytyrës së Vreosur i Unamunos është një kërkues i shëlbimit, marrëzia e vetme e të cilit është kryqëzata kundër vdekjes: "E madhe që marrëzia e Don Kishotit, ishte e madhe, sepse e tillë që edhe rrënja që e ushqeu: dëshira e pashuar për të mbijetuar, burimi i shumicës së marrëzive më të mëdha, si dhe i pjesës dërrmuese të akteve heroike."

Nga ky këndvështrim, marrëzia e Donit është refuzim i atij që Frojdi quante "testim i realitetit", apo parim i realitetit. Kur Don Kishoti bën miq me domosdoshmërinë e vdekjes, ai vdes edhe vetë, duke iu kundërvënë kësaj një krishterimi të konceptuar si kult i vdekjes – dhe jo vetëm nga Unamunoja midis vizionarëve spanjollë. Për Unamunon, gëzimi i librit i përket vetëm Sanço Pançës, që e shfaqëson daimon-in e tij, Don Kishotin, dhe e ndjek me ëndje nëpër çdo mynxyrë. Ky lloj leximi bën fqinjëri me shëmbëlltërinë e jashtëzakonshme të Kafkës, "E vërteta mbi Sanço Pançën", ku Sançoja përvetëson të gjitha romancat kalorësiake, ndërsa demoni i tij imagjinari, Doni, nisat në kuturitë e veta si prijëtar i tij. Me sa duket, Kafka po e katandiste Don Kishotin në një shaka të stërzgjatur e, doemos, të vrerët çifute, dhe ky lexim është më bindës sesa leximi i Auerbahut si një gëzim i kulluar.

Ka të ngjarë që vetëm *Hamleti* të cytë interpretime aq të ndryshme sa *Don Kishoti*. Asnjëri prej nesh nuk mund ta dëlirë *Hamletin* prej interpretuesve të tij romantikë dhe *Don Kishoti* e ka frymëzuar shkollën romantike të kritikës, po aq sa edhe librat e esetë që i kundërvihen një idealizimi të tillë të protagonistit të Servantesit. Romantikët (ndër ta edhe unë) e kundrojnë Kishotin si hero, jo si të marrë, dhe nuk pranojnë ta lexojnë librin, para së gjithash, si satirë, madje shquajnë në vepër një qëndrim metafizik a vizionar, duke bërë kësaj që ndikimi sevantinian mbi Mobi Dikun të duket fare i natyrshëm. Nga filozofi dhe kritiku gjerman Sheling, më 1802, e deri te komedia muzikore e Brodueit "Burri i la Mançës", më 1966 ka vijuar ekzaltimi i pamundësisë së përmbushjes së ëndrrës. Ithtarët kryesorë të kësaj apoteoze të Don Kishotit janë romancierët: ndër admiruesit e tij të shumtë, do të zëmë ngoje Fildingun, Smoletin e Sternin në Angli, Gëten e Tomas Manin në Gjermani, Stendalin e Floberin në Francë, Melvilin e Mark Tuenin në Shtetet



e Bashkuara dhe pothuajse të gjithë shkrimtarët hispano-amerikanë. Dostojevski, që mund të na duket si shkrimtari më pak servantian i mundshëm, ngulte këmbë se princi Mishkin tek *Idioti* ishte mbujtur sipas shëmbëlltyrës së Don Kishotit. Meqenëse eksperimenti i jashtëzakonshëm i Servantesit është në zanafillë të romanit, që i kundërvihet rrëfimit pikaresk, përshtirëria e kaq shumë romancierëve të mëvonshëm është fare e kuptueshme; por pasionet vigane që zgjon libri, veçanërisht te Stendali e Floberi, janë homazhe të jashtëzakonshme për arritjen e tij.

Unë vetë, kur lexoj *Don Kishotin*, prirem nga Unamunoja, sepse për mua thelbi i librit është zbulesa dhe kremtimi që ai i bën individualitetit heroik të Donit e të Sanços.

Unamunos, – me të padrejtë, – i pëlqente më shumë Doni sesa Servantesi, por në këtë pikë unë refuzoj t'i vete pas, sepse asnjë shkrimtar tjetër, veç Servantesit, nuk ka arritur të ndërtojë marrëdhënie më të ngushta me protagonistin e tij. Do të kishim dashur të dinim se ç'mendonte Shekspiri për Hamletin; dimë thujse për së tepërmi se sa shumë Don Kishoti e prekte Servantesin, ndonëse, shpesh, të dhënat tona janë të tërthorta.

Servantesi shpiku rrugë të pafundme për të thyer rrëfimin, në mënyrë që historinë ta rrëfejë vetë lexuesi dhe jo autori i kujdesshëm. Magjistarët finokë e dashakëqij, që, me sa duket, punojnë pareshtur për të thyer madhërisht të paepurin Don Kishot, kanë marrë përsipër, po ashtu, të na shndërrojnë në lexues të pazakontë aktiv.

Doni lë të kuptohet se shtriganët ekzistojnë vërtet, ndërsa Servantesi i realizon ata konkretisht si përbërës vendimtarë të gjuhës së tij. Gjithçka shndërrohet me anë të magjisë: kjo është ankesa e përhershme kishotiane, veçse shtrigani i prapë është vetë Servantesi.

Personazhet e tij i kanë lexuar të gjitha historitë për shoqi-shoqin dhe shumica e pjesës së dytë të romanit merret me reagimin e tyre pasi kanë lexuar pjesën e parë. Lexuesi është mësuar me reagime më të stërholluara, edhe kur Don Kishoti refuzon, me kryeneçësi, të zërë mend, ndonëse refuzimi ka të bëjë më shumë me “marrëzinë” e tij, sesa me statusin imagjinar të romancave kalorësiake që e kanë marrosur. Doni dhe Servantesi evoluojnë së bashku drejt një lloji të ri të dialektikës letrare që shpall fuqinë dhe njëherësh, kotësinë e rrëfimit, në varësi të marrëdhënieve me ngjarjet reale. Ashtu siç i kupton Doni në pjesën e parë kufizimet e trillimit, kështu edhe Servantesi nis të krenohet për autorësinë, sidomos të lumturohet që ka trilluar Donin e Sançon.

Marrëdhënia e përzemërt, ndonëse shpesh zemërake, midis Kishotit e Sanços, përbën edhe madhështinë e librit, madje më tepër sesa shija me të cilën janë paraqitur realitetet natyrore e shoqërore. Ajo që e lidh Donin me shqytarin e tij, është pjesëmarrja e ndërsjellë në atë që quhet “rregulli i lojës”, ndërsa ndërsjelltësia e tyre është një dashuri noprane për shoqi-shoqin.

Nuk di të ketë në letërsinë perëndimore një tjetër miqësi që të mund të përqaset me të, me një fjalë, që të mbështetet kaq hijshëm si kjo në një kuvendim zbatimës. Angus Fleçeri te *Ngjyrat e mendjes* arrin të rrokë atmosferën e tyre: “Kishoti dhe Sançoja pikëtakohen në një lloj të caktuar frymëzimi, në harlisjen e kuvendimeve të tyre. Duke biseduar dhe shpesh, duke rrahur mendime me zjarr, ata zgjerojnë fushën e mendimeve të njëri-tjetrit. Nuk ka mendim që t'i shpëtojë kritikës së tjetrit. Falë mosmarrëveshjeve, përgjithësisht të njerëzishme, akoma e më të njerëzishme kur konflikti është edhe më i mprehtë, ata duarduarshëm sheshtojnë një shesh të lirë loje, ku mendimet mund të peshohen prej ne lexuesve.”

Nga kuvendimet e pafundme Kishot-Sanço, ai që më pëlqen më tepër gjendet në pjesën e dytë, kapitulli 28, ku kalorësi rivalizon me Sër Xhon Flastafin për dobinë e maturisë, si pjesa më e vyer e trimërisë. Për



fat të keq, vendimi i tij nënkupton braktisjen e Sanços së shushatur në një fshat idhnakësh. Pas ndeshtrashës, i gjori Sanço ankohet se i dhemb i tërë trupi, por në këmbim merr nga kalorësi vetëm një palo ngushëllim:

– *Arsyeja e dhembjes, – tha Don Kishoti, – dubet kërkuar pa fjalë në hurin i cili, duke qenë i gjerë dhe i drejtë, ta përfshiu mirë tërë kurrizin ku ndodhen të vendosura tërë ato pjesë që të dhembin dhe sikur më e madhe të kish qenë përfshirja, më e madhe do kish qenë, të jesh i sigurt, edhe dhembja.*

– *Zotëria juaj më shpëtoi, për besë, nga një dyshim i madh dhe sa bukur e shkoqur m'i shpjegoi të gjitha, – tha Sançoja. – I mjeri unë, i mjeri, po kaq thellë e fshehur dhe mbuluar paskësh qenë ky shkak i të dhemburave të mia, sa të ish nevoja të më thoni që më shemb atje ku më arrin huri e jo gjetkë?”*

Përkthyer nga Petro Zheji

Prapa këtij kuvendimi fshihet e gjithë marrëdhënia e tyre që, nën sipërfaqe, gëzon familjaritetin e barazisë. Ne mund të pyesim se cila është figura më origjinale, veçse nuk duhet të harrojmë se figura që ata mbujnë së bashku është shumë më origjinale se secila prej tyre e marrë veç e veç. Si një çift i dhembshur e gërnjar që janë, Sançon dhe Donin i lidh më shumë dashuria e ndërsjellë dhe respekti i vërtetë për njëri-tjetrin. Në më të mirën e tyre, ata janë shokë, në rregullin e lojës, një sferë kjo me rregullat dhe vizionin e saj të realitetit: Unamunoja është sërish kritiku i vyer servantinian, por teoricieni është Johan Huizinga me librin e tij të mprehtë *Homo*

Ludens (1944), që vetëm sa e cek përkritazi Servantesin. Huizinga pohon se subjekti i tij, loja, duhet të ndahet, si nga komedia, ashtu edhe nga marrëzia: “Kategoria e komikes lidhet me marrëzinë në kuptimin më të epërm dhe më të ulët të fjalës. Sidoqoftë, loja nuk është aspak marrëzi. Ajo qëndron përtej antitezës së urtësisë dhe marrëzisë.”

Don Kishoti nuk është as i çmendur, as i marrë, por një njeri që luan rolin e një kalorësi të arratisur. Për ndryshim nga çmenduria dhe marrëzia, loja është një veprimtari e vullnetshme.

Loja, sipas Huizingës, ka katër tipare kryesore: lirinë, çinteresimin, përjashtimin a kufizimin dhe rregullin. Të gjitha këto cilësi mund t'i sprovoni mbi kalorësinë arratiake të Donit, por jo gjithnjë dhe mbi shërbimin besnik të Sanços, si shqytar, sepse Sançoja mëson t'i jepet lojës tërësisht. Doni e ngre veten në vendin dhe në kohën ideale dhe i qëndron besnik lirisë, çinteresimit, veçimit dhe cazeve të tij, gjersa, më në fund, epet, braktis lojën, i kthehet “urtësisë” së krishterë dhe, ndaj, vdes. Unamunoja thotë se Kishoti u vu në kërkim të atdheut të tij të njëmendtë, të cilin e gjeti në syrgjyn. Si gjithnjë, Unamunoja e kuptoi sërish se cili ishte thelbi i librit të madh. Doni, ashtu si hebrejnë dhe maorët, është në mërgim, por në një mërgim të brendshëm, njëlloj si *conversot* e *moriscot*. Don Kishoti lë fshatin për të kërkuar në mërgim shtëpinë e tij të frymës, sepse vetëm në mërgim ai mund të jetë i lirë.

Përktheu Azem Qazimi

Fragment nga libërthi “*Servantesi: Loja e botës*”,
Botimet Zenit.

G. G. MÁRQUEZ

SHQIPËRIMI I PARË NGA ORIGINALI
MIRA MEKSI

njëqindvjetvetmi

OnufriRoman

